




UDHËZUES PËR MËSUESIN KOORDINATOR TË SIGURIMIT TË CILËSISË

ASCAP, 2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 81 prot.

Tiranë, më 09.01.2025

URDHËR

Nr. 3, datë: 09.01.2025

PËR

MIRATIMIN E “UDHËZUESIT PËR MËSUESIN KOORDINATOR TË SIGURIMIT TË CILËSISË”

Mbështetur në ligjin nr. 69, 2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të shkronjës “ë”, në pikën 5, kreu III, të Vendimit nr.98, datë 27.02.2019, të Këshilli të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” (ASCAP), në Urdhrin e Ministrit nr.32, datë 28.01.2020, “Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”, në udhëzimin e MAS nr.16, datë 22.07.2024, “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, në urdhrin nr. 463, datë 30.08.2024, të MAS “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e “Mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë” dhe të “Mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës” në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”,

URDHËROJ:

- 1) Miratimin e “Udhëzuesit për mësuesin koordinator të sigurimit të cilësisë”.
- 2) Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzuesi Drejtoria e Kurrikulës dhe Kualifikimit, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Gerti JANAQI



TABELA E PËRMBAJTJES

I.	HYRJE.....	4
II.	QËLLIMI I UDHËZUESIT	6
III.	KONCEPTI I MËSUESIT KOORDINATOR PËR SIGURIMIN E CILËSISË.....	8
3.1	Koncepti i mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë	8
3.2	Rëndësia e rolit të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë në institucionin arsimor	8
IV.	PËRGJEGJËSITË E MËSUESIT KOORDINATOR TË SIGURIMIT TË CILËSISË.....	9
V.	PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI I VEPRIMTARIVE.....	12
VI.	PARIME PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE	18
VII.	METODAT PËR VEPRIMTARITË E ZHVILLIMIT TË BRENDSHËM PROFESIONAL	20
VIII.	VËZHGIMI NË KLASË DHE MBËSHTETJA E MËSUESVE	22
8.1	Treguesit kryesorë të vëzhgimit në klasë dhe të mbështetjes së mësuesve.....	22
8.2	Fazat kryesore të vëzhgimit të orës së mësimi.....	23
8.3	Modele të vëzhgimit të orës së mësimi	23
8.4	Formati i vëzhgimit të orës së mësimi.....	23
8.5	Sugjerime për komente konstruktive pas vëzhgimeve.....	24
8.6	Shembuj pyetjesh dhe komentesh për analizën dhe diskutimin e vëzhgimit	24
8.7	Kriteret e vlerësimit të vëzhgimit	25
IX.	ANALIZA E REZULTATEVE TË NXËNËSVE PËR PËRMIRËSIMIN E ARRITJEVE TË TYRE.....	26
9.1	Aksesi për lloje të ndryshme të të dhënave	26
9.2	Analiza e të dhënave të mbledhura	26
9.3	Raportimi dhe komunikimi	27
9.4	Metodat në analizën e të dhënave për përmirësimin e arritjeve të nxënësve	27
9.5	Lidhja ndërmjet rezultateve të analizës dhe veprimtarisë që duhet të organizojë mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë.....	30
9.6	Sfidat e angazhimit të mësuesve në analizën e të dhënave	32
X.	DOKUMENTACIONI QË MBAN MËSUESI KOORDINATOR I SIGURIMIT TË CILËSISË.....	35



10.1	Dokumente për dimensionin zhvillimin të vazhdueshëm profesional të mësuesve	35
10.2	Dokumente për dimensionin e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit të arritjeve të nxënësve	36
10.3	Dokumente për dimensionin e planifikimit dhe të zhvillimit të kurrikulës në institucionin arsimor	36
10.4	Raporti vjetor i realizimit të veprimtarive.....	36
XI.	ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL I MËSUESIT KOORDINATOR TË SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMI I PERFORMANCËS	39
11.1	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë	39
11.2	Vlerësimi i performancës së mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.....	40
XII.	ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE	41
XIII.	SHTOJCAT	46
13.1	Shtojca 1: Shembuj të formulimit objektivave dhe model kalendari për planin vjetor të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë	46
13.2	Shtojca 2: Format i instrumentit për vlerësimin e orës mësimore	50
13.3	Shtojca 3: Format i instrumentit për vlerësimin e projektit kurrikular	51
13.4	Shtojca 4: Kriteret e vlerësimit të orës mësimore.....	52
13.5	Shtojca 5: Kriteret e vlerësimit të projektit kurrikular.....	58
13.6	Shtojca 6: Model relacioni për një aktivitet të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në nivel shkolle .	60
13.7	Shtojca 7: Model pyetësori për efektivitetin e aktivitetit të ZHVP-së	61
13.8	Shtojca 8: Format i vlerësimit të performancës së mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë	62
13.9	Shtojca 9: Kriteret e vlerësimit të përgjegjësive profesionale të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë	68
13.10	Shtojca 10: Databaza e të dhënave për çdo mësues për identifikimin e nevojave për ZHVP-së	74



I. HYRJE

Cilësia në shkollë është hulumtim i vazhdueshëm që kërkon përkushtim, bashkëpunim dhe një vizion të përbashkët midis të gjithë aktorëve. Një shkollë cilësore është ajo që garanton një standard të lartë arsimor, përmbush synimet dhe qëllimet kombëtare arsimore dhe mbështet në mënyrë efektive zhvillimin e përgjithshëm të nxënësve. Për një shkollë të tillë kërkohet angazhimi i të gjithë stafit në një proces të vazhdueshëm dhe sistematik vlerësimi të efektivitetit të praktikave mësimore, me qëllim që këto praktika mësimore të përmbushin standardet e vendosura, të përmirësohen vazhdimisht dhe të çojnë në arritjen e rezultateve pozitive për nxënësit.

Duke u përqendruar në monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e komponentëve kyç të procesit mësimor, shkolla identifikon nevojat specifike të çdo punonjësi arsimor, harton plane konkrete për zhvillimin e vazhdueshëm profesional, për krijimin e një mjedisi të nxëni që jo vetëm plotëson nevojat arsimore të nxënësve, por edhe i përgatit ata për një të ardhme përmbushëse dhe të suksesshme.

Cilësia në shkollë përfshin tri dimensione të ndryshme dhe të shumanshme, ndërveprimi dhe lidhja e të cilave garanton një mjedis arsimor efektiv. Këto tri dimensione janë: *zhvillimi i vazhdueshëm profesional i punonjësve arsimorë, sigurimi i cilësisë dhe përmirësimi i arritjeve të nxënësve, cilësia e zbatimit të kurrikulës në shkollë.*

Dimensioni i parë: Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve

Cilësia e zhvillimit të vazhdueshëm profesional (ZHVP) për mësuesit ka një ndikim të thellë në cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe rrjedhimisht në rezultatet e nxënësve. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i ndihmon mësuesit të jenë në koherencë me strategjitë, metodologjitë dhe teknologjitë më të fundit të mësimdhënies, duke u mundësuar atyre të japin mësim më efektive dhe më tërheqëse. ZHVP siguron që mësuesit të kenë njohuri të thelluara për lëndën dhe një kuptim më të qartë e të plotë të saj, gjë që rrit aftësinë e tyre për të shpjeguar qartë dhe saktë konceptet komplekse. Ndërkohë është e rëndësishme që mësuesit të njihen në mënyrë të vazhdueshme me metoda inovative të mësimdhënies që mund ta bëjnë mësimin më ndërveprues ku nxënësit të jenë në aktivitet të vazhdueshëm. Studimet tregojnë se nxënësit e

mësuesve që angazhohen në zhvillim të vazhdueshëm profesional me cilësi të lartë, kanë rezultate më të larta.

Dimension i dytë: Sigurimi i cilësisë dhe përmirësimi i arritjeve të nxënësve

Cilësia e arritjeve të nxënësve pasqyron jo vetëm suksesin mësimor, por edhe zhvillimin e përgjithshëm, mbështetjen e barabartë të të gjithë nxënësve dhe gatishmërinë e përpjekjet e tyre për përmirësim në të ardhmen. Kjo nënkupton performancë të lartë në vlerësime të brendshme dhe të jashtme, provime dhe vlerësime të standardizuara, si dhe zotërim të mirë të kurrikulës. Gjithashtu nxënësit demonstrojnë aftësi krijuese, aftësi për të menduar në mënyrë kritike, për të zgjidhur probleme komplekse dhe për të zbatuar njohuritë në kontekste të ndryshme nga jeta reale. Nxënësit shfaqin aftësi të forta sociale dhe emocionale, duke përfshirë ndjeshmërinë, bashkëpunimin, fleksibilitetin dhe vetërregullimin. Ata marrin pjesë në aktivitete fizike dhe në aktivitete që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien fizike. Është e rëndësishme që nxënësit të angazhohen në aktivitetet që nxisin të mendimin krijues dhe inovativ, duke u shprehur përmes arteve, projekteve dhe aktiviteteve jashtëshkollore. Ata përgatiten më mirë për karrierën e tyre, duke zotëruar njohuritë, aftësitë dhe prirjet e nevojshme të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Element i rëndësishëm i cilësisë në arritjet e nxënësve është edhe mbështetja për nxënës me aftësi ndryshe. Shkolla mbështet në mënyrë efektive nxënësit me nevoja të ndryshme mësimore, duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara, nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar. Në këtë kuadër shkolla përdor metoda dhe teknika të ndryshme të mësimdhënies, si dhe kombinime të vlerësimeve formuese dhe përmbledhëse për të matur të nxënëit e nxënësve dhe për të përmirësuar mësimdhënien duke nxitur progresin e tyre.

Dimension i tretë: Cilësia e zbatimit të kurrikulës në shkollë

Zbatimi i kurrikulës me cilësi të lartë është thelbësor për të siguruar që të gjithë nxënësit të marrin një edukim gjithëpërfshirës, tërheqës dhe efektiv. Cilësia e zbatimit të kurrikulës në një shkollë ndikon ndjeshëm në rezultatet e përgjithshme të shkollës dhe në arritjet e nxënësve. Kurrikula mbulon një gamë të gjerë lëndësh, duke përfshirë fushat kryesore të gjuhës dhe të komunikimit, të matematikës, të shkencave të natyrës, të shkencave shoqërore, të teknologjisë dhe inovacionit, të arteve, të edukimit fizik, si dhe një sërë çështjesh ndërkurrikulare. Përmbajtja e kurrikulës është e rëndësishme për jetën dhe për interesat e nxënësve. Për një zbatim sa më

cilësor të kurrikulës, mësuesit duhet të përdorin metoda mësimore që janë efektive përmes aktualizimit, kërkimit dhe praktikës, si dhe metoda që nxisin mësimin e diferencuar për të përmbushur nevojat dhe stilet e ndryshme të të nxëniet të të gjithë nxënësve. Në këtë kuadër një shumëllojshmëri metodash vlerësimi përdoren për të matur të nxëniet e nxënësve, duke përfshirë vlerësimet formuese për të nxitur progresin e nxënësit dhe vlerësimet përmbledhëse për të vlerësuar arritjet e përgjithshme të kompetencave të tyre. Kjo nënkupton që nxënësit marrin në kohë reale komente konstruktive për performancën e tyre për të përmirësuar procesin e të nxëniet. Disponueshmëria e burimeve është një element tjetër i rëndësishëm i cilësisë së zbatimit të kurrikulës. Përdorimi efektiv i teknologjisë, i inteligjencës artificiale dhe i platformave interaktive mundëson ofrimin cilësor të kurrikulës dhe rrit angazhimin e nxënësve. Orët mësimore përfshijnë aktivitete ndërvepruese dhe praktike që e bëjnë mësimin më tërheqës dhe më kuptimplotë. Zbatimi i kurrikulës në bazë shkolle sipas interesave dhe nevojave të nxënësve nxisin një ndjenjë pronësie dhe motivimi për ta.

II. QËLLIMI I UDHËZUESIT

Mësuesi koordinator për sigurimin e cilësisë luan një rol vendimtar në sigurimin e cilësisë në shkollë. Udhëzuesi për mësuesin koordinator për sigurimin e cilësisë është hartuar për të mbështetur mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë në rolin e tyre për të siguruar dhe për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies brenda institucionit të tyre arsimor. Roli i një mësuesi koordinator të sigurimit të cilësisë është i rëndësishëm në ruajtjen e standardeve të larta të mësimdhënies dhe të nxëniet, në nxitjen e zhvillimit profesional të mësuesve dhe në zbatimin e proceseve efektive të mësimdhënies për të siguruar rezultate të larta të nxënësve.

Hartimi i udhëzuesit mbështetet në udhëzimin nr. 16 datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë” dhe në urdhrin e MAS, nr. 463, datë 30.08.2024 “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe të mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë udhëzime të qarta, praktike dhe gjithëpërfshirëse për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë. Ai synon:

- të mbështesë mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë për organizimin e veprimtarive të zhvillimit të brendshëm profesional dhe sigurimit të cilësisë në shkollë;
- të përcaktojë rolet, përgjegjësitë dhe pritshmëritë kryesore të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë;
- të orientojë mësuesin koordinator të sigurimit të cilësisë me modele të planifikimit dhe të zhvillimit të strategjive për mbështetjen dhe rritjen profesionale të stafit mësues;
- të përcaktojë standarde dhe praktika të qëndrueshme për të siguruar përvoja të mësimit dhe të të nxënësve me cilësi të lartë;
- të ofrojë teknika të mbledhjes dhe të analizimit të të dhënave për rezultatet e nxënësve;
- të ofrojë modele të raportimit dhe të komunikimit me të gjithë institucionet përkatëse;
- të sugjerojë veprimtari për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë;
- të përshkruajë rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve dhe të institucioneve për garantimin e funksionimit efektiv të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë në shkollë;
- t'u vijë në ndihmë Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP-ve) dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP-eve) për mbështetjen, koordinimin dhe monitorimin e veprimtarive të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë;
- t'i vijë në ndihmë Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP) dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për monitorimin e veprimtarive të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.

Ky udhëzues shërben si një udhërrëfyes për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë, duke ofruar këshilla praktike dhe veprimtari për të arritur këto qëllime. Duke ndjekur këtë udhëzues, mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë mund ta kryejnë me sukses rolin e tyre drejt standardeve më të larta të mësimit dhe të të nxënësve.



III. KONCEPTI I MËSUESIT KOORDINATOR PËR SIGURIMIN E CILËSISË

3.1 Koncepti i mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë

Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë është rol i ri dhe i rëndësishëm brenda shkollës. Ky mësues është punonjës në institucionin arsimor dhe është përgjegjës për të siguruar që mësimdhënia dhe të nxëniet të jenë cilësore dhe që të gjithë nxënësit të mbështeten sipas nevojave të tyre. Ai punon në bashkëpunim me stafin drejtues, mësuesit, nxënësit dhe komunitetin e gjerë të arsimit për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxëniet në institucionin arsimor parauniversitar. Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë planifikon dhe realizon veprimtari në mbështetje të ngritjes së kapaciteteve të brendshme të mësuesve dhe të rritjes së cilësisë së institucionit arsimor. Ai mund të kryejë kërkime, të analizojë të dhëna dhe të ndihmojë vendimmarrjen në shkollë duke u bazuar në arritjet e nxënësve dhe të planifikojë veprimtari për përmirësimin e tyre. Mësuesi koordinator për sigurimin e cilësisë vepron shpesh si një urë lidhëse midis mësuesve, stafit drejtues dhe, ndonjëherë, autoriteteve të jashtme arsimore. Mësuesi koordinator për sigurimin e cilësisë ndihmon në zbatimin dhe në menaxhimin e projekteve që mund të ketë shkolla. Ai gjithashtu mund të bashkëpunojë me partnerë të jashtëm ose me palë të interesuara për të rritur efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e projekteve.

3.2 Rëndësia e rolit të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë në institucionin arsimor

Shoqëria shqiptare pret nga shkolla që të krijojë kushte dhe mundësi që nxënësit: të kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore; të përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare; të zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike; të zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit; të aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore; të aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës; të zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes, të jenë krijues dhe inovativë; të përdorin teknologjitë dhe platformat e reja interaktive, inteligjencën artificiale etj. Roli i mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm, pasi mësuesit duhet të jenë të aftë të përgatisin nxënës me këto kërkesa. Ai luan një rol të rëndësishëm për të siguruar arritje të larta dhe mirëqenien e nxënësve, si dhe përmbushjen e pritshmërive në ofrimin e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës. Rëndësia e këtij roli lidhet me parimet e mëposhtme:



- *Përmirësimi i vazhdueshëm:* Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë ndihmon shkollat të krijojnë dhe të ruajnë një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm, duke vlerësuar vazhdimisht praktikat e mësimdhënies.
- *Qëndrueshmëria:* Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë siguron që cilësia të jetë e qëndrueshme te nxënësit, klasat dhe shkolla.
- *Përgjegjësia:* Mësuesi koordinator mbështet shkollat që të përmbushin dhe të tejkalojnë përparësitë arsimore të vendosura nga institucionet politikëbërëse duke u përballur me sfidat arsimore.
- *Mbështetja e mësuesve:* Mësuesi koordinator mbështet mësuesit në rritjen e tyre profesionale, duke ofruar burime dhe mundësi zhvillimi profesional.
- *Rezultatet e nxënësve:* Puna e mësuesit koordinator kontribuon më së shumti në përmirësimin e rezultateve të të nxënësve dhe në mirëqenien e tyre.
- *Përshtatja:* Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë ndihmon shkollat që të përshtaten me ndryshimin e reformave arsimore, me teknologjitë e reja dhe me zhvillimin e praktikave më të mira në mësimdhënie.

IV. PËRGJEGJËSITË E MËSUESIT KOORDINATOR TË SIGURIMIT TË CILËSISË

Përgjegjësitë e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë përmblihen në tri dimensione të rëndësishme: zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve të institucionit arsimor; sigurimi i cilësisë dhe përmirësimi i arritjeve të nxënësve; zbatimi cilësor dhe efektiv i kurrikulës në institucionin arsimor. Përgjegjësitë e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë për secilin dimension përmblihen si më poshtë:

1. Përgjegjësitë e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë ***për dimensionin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve*** janë:
 - a) Njeh programin kombëtar të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve dhe i nxit ata të jenë pjesë e këtij programi.
 - b) Analizon rregullisht nevojat për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve, duke u bazuar në rezultatet e nxënësve, në rezultatet e kualifikimit të mësuesve, në rezultatet e provimeve kombëtare dhe të vlerësimeve ndërkombëtare.

- c) I propozon drejtorit të shkollës nisma të reja për zhvillimin e brendshëm të stafit mësues.
 - d) Harton në bashkëpunim me stafin drejtues, planin e aktiviteteve për zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe të sigurimit të cilësisë.
 - e) Koordinon procesin e zbatimit të planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, duke nxitur edhe shkëmbimin e përvojave të mësuesve me njëri-tjetrin.
 - f) Krijon mundësi për të gjithë mësuesit të marrin pjesë në aktivitete të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, duke siguruar numrin e nevojshëm të krediteve vjetore për çdo mësues.
 - g) Ofron udhëzime, mbështetje dhe inkurajim për mësuesit e rinj dhe veçanërisht për ata që akoma nuk kanë fituar kategorinë “Mësues i kualifikuar”.
 - h) Vëzhgon mësuesit në procesin mësimor për efektivitetin e aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në procesin mësimor dhe i inkurajon ata të përdorin aftësitë e fituara gjatë veprimtarive të ZHVP-së.
 - i) Mbështet mësuesin kandidat për procesin e kualifikimit në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e orës mësimore të hapur dhe/ose orës së projektit kurrikular.
 - j) Merr pjesë dhe vlerëson orën mësimore të hapur dhe/ose orën e projektit kurrikular të realizuar nga mësuesi kandidat për procesin e kualifikimit.
 - k) Mbështet stafin drejtues në aplikimin dhe në menaxhimin e projekteve që mund të ketë shkolla.
2. Përgjegjësitë e mësuesit koordinator për **dimensionin e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e arritjeve të nxënësve** janë:
- a) Mbështet dhe monitoron punën e mësuesve për të gjitha llojet dhe mënyrat e vlerësimit të nxënësve.
 - b) Mbështet stafin drejtues në analizën rezultateve të nxënësve sipas periudhave mësimore dhe vjetore, për të mbështetur dhe për të nxitur përparimin e tyre.
 - c) Mbështet dhe ndjek zbatimin e planeve për përmirësimin e rezultateve të nxënësve, përgatitjen e tyre për provimet kombëtare, vlerësimet ndërkombëtare, olimpiadat, konkurset etj.

- d) Mbështet stafin drejtues për analizën e rezultateve të nxënësve në provime kombëtare, vlerësime ndërkombëtare, olimpiada, konkurse etj.
 - e) Bën rekomandime në drejtorinë e shkollës që nxënësit të marrin mbështetje të mjaftueshme për provimet kombëtare, vlerësimet ndërkombëtare, olimpiadat, konkurset etj., siç janë këshillimi, orë mësimore shtesë, konsultime, testime përgatitore etj.
 - f) Mbështet stafin drejtues për zhvillimin e procesit të vetëvlerësimit të shkollës.
3. Përgjegjësitë e mësuesit koordinator për ***dimensionin e planifikimit dhe të zhvillimit të kurrikulës në institucionin arsimor*** janë:
- a) Koordinon punën në bashkëpunim me kryetarët e ekipeve lëndore për hartimin e planeve lëndore.
 - b) Udhëzon mësuesit në bashkëpunim me kryetarët e ekipeve lëndore, për përdorimin e materialeve mësimore dhe të metodologjive bashkëkohore (përfshirë qasjen STEM dhe përdorimin e TIK-ut), kriteret e hartimit të testeve, planifikimin dhe zhvillimin e projekteve lëndore dhe ndërlëndore, analizën e arritjeve të nxënësve etj.
 - c) Harton një kalendar, në bashkëpunim me mësuesit, për vëzhgimin e orëve mësimore të mësuesit, me qëllim identifikimin e nevojave për zhvillim profesional, mbështetjen dhe promovimin e praktikave pozitive në shkollë.
 - d) Vëzhgon orë mësimore të mësuesit dhe ofron rekomandime për përmirësimin e cilësisë së tyre.
 - e) Mbështet zbatimin e risive kurrikulare në shkollë dhe propozon me shkrim përmirësime të kurrikulës dhe të teksteve shkollore, të cilat i dorëzon në përfundim të vitit shkollor në drejtorinë e shkollës.
 - f) Koordinon punën për planifikimin dhe për zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle, në përputhje me nevojat dhe me interesat e nxënësve, si dhe bazuar në kontekstin e shkollës.
 - g) Propozon ide inovatore në organizimin e aktiviteteve shkollore, me synimin për t'iu përgjigjur nevojave të nxënësve, si dhe pritshmërive të prindërve dhe të komunitetit.

V. PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI I VEPRIMTARIVE

Funksionimi i rolit të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë bazohet në mirëplanifikimin e veprimtarive të tij dhe zhvillimin sa më cilësor dhe efektiv të tyre. Veprimtaritë planifikohen për një vit shkollor, të ndara sipas dimensioneve.

Norma e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë përshkruhet në urdhrin e MAS-it, nr. 463, datë 30.08.2024 “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe të mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”.

Një model për ndarjen e orëve sipas veprimtarive jepet më poshtë. Supozojmë se mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë e ka normën javore 30 orë punë (60 minutëshe) në shkollë nga të cilat 6 orë janë orë mësimore (45 minutëshe) sipas profilit përkatës të mësuesit. Atëherë ndarja e orëve të punës mund të jetë si në tabelën 1.

Tabela 1. Koha javore e punës së mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë (Shembull)

	Rubrika	Orë pune (60 minuta) javore	Sqarime për realizimin e kohës së punës
1	Koha për mësimdhënie në shkollë (në këtë model është 6 orë).	6 orë 45 minutëshe = 4.5 orë 60 minutëshe	Në këtë shembull është marrë norma më e ulët e përcaktuar si mësues. Ajo përcaktohet sipas profilit të mësuesit dhe pasqyrohet në orarin mësimor, duke lehtësuar punën e mësuesit në rastet kur mbulon disa shkolla. Në raste të veçanta mund të realizohet në 2 ditë për të mundësuar lëvizjen e tij në shkolla të tjera kur këto janë të shpërndara gjeografikisht, p.sh., nëse janë në disa fshatra.
2	Planifikimi për orët e mësimdhënies	2 orë	Mësuesi harton planin ditor për orët mësimore që ka në ngarkesën mësimore.
	Dimensioni “Zhvillimi profesional i mësuesve në nivel shkolle”	5 orë (rekomandohen 2 orë vëzhgime të orëve mësimore në javë) ¹	Këto orë përdoren për realizimin e veprimtarive të përcaktuara më poshtë për këtë dimension. Shembull:

¹ Koordinator i sigurimit të cilësisë planifikon vëzhgimet në orët mësimore duke u bazuar në specifikat dhe në nevojat e mësuesve për ZHVP.

			<ul style="list-style-type: none"> - 2 orë mësimi (45 minutëshe) = 1.5 orë (60 minuta) vëzhgime të orëve mësimore në javë. - 1 orë (60 minuta) takimi pas orës mësimore me çdo mësues në veçanti, 25-30 minuta për secilin²; - 2,5 orë (60 minuta) veprimtaritë me: mësuesit e ekipeve lëndore; mësuesit ndihmës; mësuesit e rinj; mësuesit mentorë; mësues që kanë kualifikimin etj.³
3	Dimensioni “Sigurimi i cilësisë dhe përmirësimi i arritjeve të nxënësve”	4 orë	<p>Këto orë përdoren për realizimin e veprimtarive të përcaktuara më poshtë për këtë dimension.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> - informimi mbi vlerësimet ndërkombëtare; - mbështetja e mësuesve për përgatitjen e nxënësve për provimet kombëtare - analiza e rezultateve të testeve përgatitore për provimet kombëtare, - etj.
4	Dimensioni “Planifikimi dhe zhvillimi i kurrikulës”	3 orë	<p>Këto orë përdoren për realizimin e veprimtarive të përcaktuara më poshtë për këtë dimension.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> - diskutimi, hartimi dhe orientimi i mësuesve për hartimin e planeve vjetore lëndore dhe planeve për çdo periudhë. - mbështetja për mësuesit në hartimin e situatave të të nxënësve, rezultateve të të nxënësve, projekteve kurrikulare, testeve etj. - mbështetja e hartimit dhe zbatimit të kurrikulës në bazë shkolle. - etj.
5	Pjesëmarrje në aktivitete për zhvillimin profesional individual.	2 orë	<p>Këto orë, pavarësisht se janë shpërndarë në normën javore të punës, mund të përmbliohen ose të zhvillohen në një kohë të caktuar duke u</p>

²Takimi me mësuesit pas zhvillimit të vëzhgimit realizohet në një kohë të përshtatshme brenda orarit të kohës së punës në përfundim të orës së mësimit nëse kjo është e mundur ose në një orë tjetër kur mësuesi e ka të lirë. Takimi mund të zhvillohet edhe një ditë më pas, nëse kjo është e dakordësuar nga të dy palët.

³Takimet me mësuesit sugjerohet që të realizohen në formë periodike dhe mund të kenë një ditë ose orar të përcaktuar, i cili mund të bëhet i njohur në orarin e shkollës. Përfundim janë rastet kur takimi do të zhvillohet me të gjithë mësuesit si në rastet e analizave, raportimeve apo trajnimeve ose seancave informuese, të cilat mund të zhvillohen në periudhat e pushimeve të nxënësve, në përfundim të procesit mësimor për atë ditë, nëse kjo është e mundur apo në fund të vitit shkollor gjatë kohës kur ka përfunduar procesi mësimor.

			llogaritur me 70-72 orë në vit për zhvillimin profesional individual.
6	Plotësim dokumentesh, plane, raporte, analiza etj.	4.5 orë	Koha vjetore për përgatitjen e dokumenteve, materialeve, raporteve dhe analizave është shpërndarë në normën javore, por ajo llogaritet 175 orë pune në vit.
7	Angazhim në veprimtari ekstrakurrikulare (p.sh.: veprimtari sportive, kulturore, konkurse, panaire etj.).	2 orë	Përfshirja në veprimtari të tjera do të bëhet në varësi të kushteve dhe kërkesave të shkollës / shkollave. Këto orë, pavarësisht se janë shpërndarë në normën javore të punës, mund të përmbliidhen ose të zhvillohen në një kohë të caktuar duke u llogaritur me 70-72 orë në vit.
8	Punë të tjera të ngarkuara nga drejtori i shkollës.	3 orë	Detyrat e tjera të ngarkuara nga drejtori i shkollës, nuk mund të jenë gjithëvjetore, por vetëm me karakter operativ dhe të ndihmës në procese të ndryshme siç është vlerësimi i brendshëm, hartimi i planit afatmesëm, karta e performancës dhe / ose analiza e riskut të shkollës.
Totali		30 orë	

Shënim. Kjo ndarje është një shembull. Në varësi të specifikave të institucionit arsimor, mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë në bashkëpunim me stafin drejtues dhe me mësuesit, përcaktojnë peshën e ndarjes së orëve të punës për rubrikat në tabelë ose shtojnë rubrika të tjera.

Mësuesi koordinator në fillim të vitit shkollor harton planin vjetor të punës në të cilën planifikon veprimtaritë që do të kryejë gjatë vitit shkollor për secilin prej dimensioneve.

Plani vjetor i mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë përmban:

- A.** Vizionin e institucionit arsimor dhe përparësitë e institucionit arsimor (nga plani afatmesëm i shkollës).
- B.** Objektivi/at vjetor/e të institucionit arsimor (nga plani vjetor i shkollës).
- C.** Objektivat vjetore të detajuara të mësuesit koordinator (shtojca nr. 1).
- D.** Kalendarin e veprimtarive që planifikohen të realizohen gjatë vitit shkollor (modeli sipas shtojcës nr. 1 për secilin prej dimensioneve). Në kalendar mund të planifikohen veprimtari si më poshtë:
 - a) *Veprimtaritë kryesore që mund të planifikohen dhe mund të zhvillohen në dimensionin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve***, përmbledhen si më poshtë:
 - 1. Veprimtari në të cilat mësuesit do të marrin pjesë në trajnimin e detyrueshëm të programit kombëtar të zhvillimit profesional.
 - 2. Veprimtari të zhvillimit të brendshëm profesional për mësuesit që hyjnë në procesin e kualifikimit, sipas rubrikave për secilën kategori: mbështetje për testin e informatizuar, mbështetje për orën e hapur mësimore, mbështetje për projektin kurrikular.
 - 3. Pjesëmarrje në orën mësimore të hapur dhe/ose në orën e projektit kurrikular, të realizuar nga mësuesi kandidat për procesin e kualifikimit.
 - 4. Trajnime për mësuesit që nuk kanë rezultate të mira në procesin e kualifikimit, të përcaktuara nga analiza e rezultateve të kualifikimit të mësuesve.
 - 5. Veprimtari të ZHVP-së për mësuesit që do të marrin pjesë në seminare /ëorkshope/ trajnime/ konferenca/ mikro-kredenciale etj., lidhur me përmirësimin e rezultateve të nxënësve në provimet kombëtare apo në vlerësimet ndërkombëtare.
 - 6. Takime (sesione) të rregullta për çdo periudhë mësimore me ekipet lëndore apo me të gjithë stafin mbi efektivitetin e aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional (të realizuara nga mësuesit), dhe mundësia e përdorimit të tyre në procesin mësimor, në mbështetje të mirëqenies psiko-sociale të nxënësve.
 - 7. Orë të hapura, ku mësuesit vëzhgojnë orët e njëri-tjetrit dhe japin reflektime konstruktive.

8. Takime (sesione) të mësuesve me përvojë me ata më të rinj për mbështetje dhe për udhëzime të vazhdueshme.
9. Takime (sesione) me specialistë të fushës për integrimin e teknologjisë duke ndihmuar mësuesit të përdorin në mënyrë efektive teknologjinë dhe platformat interaktive në klasat e tyre.
10. Krijimi i mundësive për pjesëmarrje ose referime në konferenca të ndryshme, të organizuara në nivel kombëtar për mësuesit.
11. Vëzhgime në orë mësimore për efektivitetin e aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në mësimdhënie, duke krahasuar kompetencat fillestare me njohuritë dhe aftësitë e fituara nga mësuesit në këto aktivitete, si dhe për të gjykuar nëse qëllimet e aktiviteteve janë përmbushur apo mësuesit kanë nevojë për përmirësim.
12. Analiza mbi llojet e aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional që janë më efektive (p.sh., trajnimet, seminarët, ëorkshopet, kurset online, rrjetet profesionale etj.), duke e përdorur këtë informacion për të përmirësuar iniciativat e ardhshme të zhvillimit profesional.
13. Aktivitete në kuadër të projekteve që mund të ketë shkolla në bashkëpunim me organizata jo qeveritare, universitete etj.

b) Veprimtaritë kryesore që mund të planifikohen dhe mund të zhvillohen në dimensionin e sigurimit të cilësisë dhe të përmirësimit të arritjeve të nxënësve, përmbledhen si më poshtë:

1. Ëorkshop (sesion) i brendshëm për analizën e të dhënave nga rezultatet e nxënësve sipas periudhave mësimore dhe përcaktimin e prioriteteve për përmirësimin e tyre, bazuar në identifikimin e pikave të forta, dobësive dhe mangësive në arritjet e tyre.
2. Aktivitete, në bashkëpunim me stafin drejtues dhe mësuesit, për përmirësimin e rezultateve të nxënësve në provimet kombëtare dhe vlerësimet ndërkombëtare.
3. Aktivitete, në bashkëpunim me stafin drejtues dhe mësuesit, për përforcimin dhe përmirësimin e arritjeve të nxënësve me aftësi të kufizuar apo me vështirësi në të nxënë.

4. Anketa dhe/ose pyetësorë me nxënësit, në bashkëpunim me stafin drejtues dhe mësuesit, lidhur me nevojat e tyre dhe stilet e të nxënësve për të siguruar mësimdhënie të diferencuar.
5. Aktivitete, në bashkëpunim me stafin drejtues dhe mësuesit, për nxënësit e talentuar në aspekte të ndryshme, si: klubet, konkurset, olimpiadat, kampionatet etj.
6. Takime (sesione) me mësuesit për të krijuar vlerësime efektive formuese dhe përmbledhëse.
7. Takime (sesione) me nxënësit për përgatitjen e tyre për provime/ testime, si: strategjitë efektive të të nxënësve, menaxhimi i kohës, menaxhimi i emocioneve dhe i stresit etj., duke lidhur mirëqenien socio-emocionale me suksesin e arritjeve mësimore.
8. Plotësime, në bashkëpunim me stafin drejtues dhe mësuesit, të instrumenteve të vetëvlerësimit të shkollës.

c) Veprimtaritë kryesore që mund të planifikohen dhe zhvillohen në dimensionin e planifikimit dhe të zhvillimit të kurrikulës, përmbledhen si më poshtë:

1. Takime (sesione) me ekipet lëndore për hartimin e planeve lëndore dhe planeve ditore, përdorimin e materialeve mësimore dhe të metodologjive bashkëkohore (përfshirë qasjen STEM dhe përdorimin e TIK-ut), kriteret e hartimit të testeve, planifikimin dhe zhvillimin e projekteve lëndore dhe ndër-lëndore, etj., në përputhje me udhëzuesit kurrikularë dhe me materialet e tjera ndihmëse, të hartuara nga ASCAP.
2. Organizimi i orëve mësimore, bazuar në projekte lëndore dhe ndërkurrikulare, si dhe zbatime të situatave nga jeta reale dhe tregu i punës, duke i inkurajuar mësuesit të krijojnë lidhje ndërmjet fushave lëndore, me qëllim që të ndihmojnë nxënësit të kuptojnë rëndësinë e mësimin të tyre në të ardhmen.
3. Takime (sesione) me ekipet lëndore për përdorimin e laboratorëve smart, për përfshirjen e arsimit të kombinuar dhe për përdorimin e inteligjencës artificiale në procesin mësimor.
4. Vëzhgime të orëve mësimore të mësuesve, në bashkëpunim me stafin drejtues dhe me mësuesit, me qëllim ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e cilësisë së tyre dhe mbështetjen dhe promovimin e praktikave pozitive në shkollë.



5. Takime (sesione) me ekipet lëndore për planifikimin dhe zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle, në përputhje me nevojat dhe interesat e nxënësve, si dhe duke u bazuar në kontekstin e shkollës.
- E. Databazën e të dhënave për çdo mësues për identifikimin e nevojave për ZHVP, për përmbushjen e detyrimit për zhvillim profesional dhe për informimin për aktivitetet e ZHVP-së në vijim (shtojca 10).

VI. PARIME PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE

Për realizimin dhe për zhvillimin sa më cilësor dhe efektiv të veprimtarive të planifikuara në planin vjetor të mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë, është e rëndësishme nxitja e një kulture të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve për rritjen e cilësisë në arsim. Disa parime nga të cilat mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë mund të udhëhiqet në punën e tij, përmbledhen si më poshtë:

- *Përafrimi me vizionin dhe me prioritetet e shkollës:* Zhvillimi i vazhdueshëm profesional të përputhet me planet e tjera të zhvillimit të shkollës. Rritja individuale e mësuesve të lidhet me rezultatet e nxënësve dhe me metrikat e performancës së shkollës sipas sistemit të meritokracisë.
- *Krijimi i një mjedisi që është gjithmonë në përmirësim dhe në rritje:* Promovimi i idesë se aftësitë mund të zhvillohen përmes përkushtimit dhe angazhimit të vazhdueshëm. Inkurajimi i përmirësimeve dhe i përpjekjeve të mësuesve, dhe jo vetëm i arritjeve të tyre. Nxitja e marrjes së riskut dhe mësimi nga dështimet për përmirësimin e punës.
- *Personalizimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional (PPZHVP):* Mbështetja e çdo mësuesi për të krijuar plane të rritjes individuale, me qëllime specifike, të matshme, të arritshme, të rëndësishme dhe të kufizuara në kohë. Përmirësimi i vazhdueshëm i këtyre planeve me mundësi edukimi në vazhdim.
- *Bashkëpunimi me mësuesit dhe me stafin drejtues,* për shembull për hartimin e *planit të vëzhgimeve*. Inkurajimi i planifikimit në bashkëpunim me ekipin lëndor. Inkurajimi i bashkëpunimit ndërmjet ekipeve lëndore për vëzhgime edhe në lëndë të tjera, lidhur me metodat efektive të mësimdhënies.

- *Përfshirja e teknologjive të reja në procesin mësimor:* Prezantimi i platformave interaktive për zhvillim të vazhdueshëm profesional me ritëm të pavarur dhe individual. Përdorimi i mediave sociale për të shkëmbyer burime të ndryshme informacioni dhe ide të reja.
- *Stimulimi i rritjes individuale,* i përpjekjeve të mësuesve për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe njohja e lidhjes së zhvillimit profesional me mundësitë e avancimit në karrierë të mësuesve. Ndarja e historive të suksesit dhe të praktikave më të mira në të gjithë shkollën, si dhe në rrjetet profesionale të mësuesve dhe në rrjetet e mësuesve koordinatorë të sigurimit të cilësisë.
- *Inkurajimi i iniciativave të ndërmarra dhe të drejtuara nga vetë mësuesit:* Mbështetja e mësuesve në kryerjen e hulumtimeve dhe kërkimeve për përmirësimin e procesit mësimor në lëndën e tyre dhe jo vetëm. Ofrimi i mundësive që mësuesit të paraqesin hulumtime dhe kërkimet e tyre para kolegëve, gjatë takimeve të zhvillimit të brendshëm profesional, rrjeteve profesionale, seminareve kombëtare, konferencave etj.
- *Nxitja dhe pjesëmarrja në projekte të jashtme:* Inkurajimi për pjesëmarrjen e mësuesve në projekte rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, binjakëzime etj. Krijimi i partneriteteve me universitetet ose me shkollat e tjera për bashkëpunime me mësuesit, me nxënësit etj.
- *Reagime dhe reflektime të rregullta për performancën e mësuesve* në procesin mësimor me fokus përmirësimin e vazhdueshëm të tyre. Zbatimi i reflektimeve konstruktive jo vetëm nga mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë dhe stafi drejtues, por edhe vetë-reflektimit midis mësuesve, madje edhe reflektim të mësuesve mbi punën e stafit drejtues dhe të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.
- *Përdorimi sistematikisht i gjetjeve nga vlerësimet e ndryshme* është strategji që zbatohet nga mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë për të garantuar që zhvillimi vazhdueshëm profesional të bëhet mjet përshtatës, i përgjegjshëm dhe gjithnjë e më efektiv për përmirësimin e mësimdhënies dhe të të nxënësve. Kjo qasje e drejtuar nga të dhënat ndihmon në krijimin e një kulture përmirësimi të vazhdueshëm dhe siguron që burimet të përdoren në mënyrë efikase për të përmbushur nevojat në zhvillim të mësuesve dhe të nxënësve.



VII. METODAT PËR VEPRIMTARITË E ZHVILLIMIT TË BRENDSHËM PROFESIONAL

Veprimtaritë në kuadër të zhvillimit të brendshëm profesional ndikojnë në rritjen e aftësive të mësuesve, shkëmbimin e njohurive dhe përmirësimin e cilësisë së arritjeve të nxënësve. Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë mund të përdorë metoda efektive të larmishme gjatë takimeve me mësuesit, ekipet lëndore etj., të cilat mund të realizohen me shkollën/at ku është koordinator.

- ✓ *Sesion praktik i përqendruar në aftësi ose në tema specifike. Shembull:* Një sesion për integrimin e teknologjisë në klasë, ku mësuesit praktikojnë përdorimin e aplikacioneve apo të platformave të reja në lëndë të ndryshme.
- ✓ *Shkëmbim ose promovim përvojash pozitive:* Mësuesit u prezantojnë kolegëve praktikat e tyre më të mira ose metoda të suksesshme. *Shembull:* Një mësues matematike demonstroi një mënyrë tërheqëse dhe praktike për të mësuar thyesat dhe veprimet me to.
- ✓ *Studime të literaturës pedagogjike:* Diskutim në grup i literaturës edukative, udhëzuesve kurrikularë apo materialeve të tjera mbështetëse për mësuesit. *Shembull:* Takim mujor për të diskutuar kapitullin e metodologjisë të “Udhëzuesi i zbatimit të kurrikulës” nga ASCAP.
- ✓ *Prezantimet të projekteve nga mësuesit:* Mësuesit ndajnë përvojat nga projektet janë angazhuar në nivel ZVAP-je, DRAP-i apo në nivel kombëtar ose ndërkombëtar. *Shembull:* Një mësues paraqet gjetje mbi përdorimin e IA-së në procesin mësimor.
- ✓ *Grupet e ekspertëve:* Mësuesit ndahen në grupe ekspertësh për tema të ndryshme dhe më pas i mësojnë të tjerët për këto tema. *Shembull:* Një grup mësuesish studioi aspekte të ndryshme të të mësuarit të bazuar në projekte, pastaj këtë informacion e ndajnë me të gjithë stafin.
- ✓ *Studim rasti:* Analiza dhe diskutimi i rasteve reale të klasës apo rasteve të nxënësve. *Shembull:* Ekzaminimi i një rasti studimor për mbështetjen e një nxënësi me vështirësi specifike në të nxënë.
- ✓ *Analiza e videos së orës mësimore:* Mësuesit shikojnë dhe analizojnë videot e orëve mësimore dhe praktikave të mësimdhënies (të tyre ose të të tjerëve). *Shembull:* Analizimi i një videoje të një mësimi shumë efektiv mbi aftësitë e të menduarit kritik, organizimit të

mjedisit të klasës (mund të jetë edhe një video nga mësues jashtë shkollës së tyre ose nga përvoja të huaja).

- ✓ *Punë brenda ekipit lëndor:* Takime të rregullta të ekipeve lëndore ose të nivelit përkatës arsimor për të bashkëpunuar dhe për të zgjidhur probleme të ndryshme për procesin mësimor dhe jo vetëm. *Shembull:* Mbështetja e takimit të radhës i ekipit lëndor të shkencës për të harmonizuar kurrikulën dhe përfshirjen e qasjes STEM.
- ✓ *Sesion të drejtuar nga mësuesit* ku temat sugjerohen dhe votohen nga të pranishmit. *Shembull:* Mësuesit propozojnë dhe drejtojnë diskutime rreth temave për të cilat ata janë të pasionuar.
- ✓ *Mikro-mësimdhënie:* Mësuesit përgatitin dhe japin mësim të shkurtra (5-10 minuta) për kolegët. *Shembull:* Secili mësues paraqet një mësim të shpejtë mbi strategjinë e tij më të suksesshme të mësimdhënies me fokus zhvillimin e mendimit krijues.
- ✓ *Panelet e ekspertëve:* Një panel mësuesish me përvojë ose ekspertë të jashtëm u përgjigjen pyetjeve nga stafi i shkollës. *Shembull:* Një panel diskutimi mbi zbatimin e një kurrikule të re të bazuar në kompetenca, me ekspertë të ftuar nga ASCAP.
- ✓ *Ekspozita teknologjike:* Mësuesit demonstrojnë në takimet e tyre përdorime efektive të teknologjisë gjatë orës së mësimit. *Shembull:* Një “panair teknologjie” ku mësuesit shfaqin aplikacionet ose mjetet e tyre të preferuara gjatë orës së mësimit.
- ✓ *Sesion i analizës së të dhënave:* Ekzaminimi i përbashkët i të dhënave të performancës së nxënësve duke u bazuar në rezultatet e vlerësimeve të periudhës mësimore. *Shembull:* Analizimi i rezultateve të standardizuara të testit të periudhës së parë për të identifikuar fushat për përmirësimin e rezultateve të tyre.
- ✓ *Simulime:* Mësuesit punojnë përmes skenarëve të simuluar për të praktikuar vendimmarrjen e tyre sipas rasteve specifike. *Shembull:* Një simulim i sfidave të menaxhimit të klasës në rastin e një konflikti brenda orës së mësimit.
- ✓ Etj.

Gjatë zbatimit të këtyre metodave dhe teknikave, mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë mban parasysh:

- a. Përshtatjen aktiviteteve me parimet e edukimit për të rritur, duke organizuar sesione tërheqëse.
- b. Sigurimin e qëllimeve të qarta për çdo takim (sesion).
- c. Fleksibilitetin e kohës për reflektim dhe aplikim në mjedis.
- d. Mbledhjen e komenteve nga mësuesit për të përmirësuar vazhdimisht procesin e zhvillimit profesional.
- e. Vazhdimësinë për vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional.
- f. Lidhjen e drejtpërdrejtë me punën e përditshme të mësuesve.

VIII. VËZHGIMI NË KLASË DHE MBËSHTETJA E MËSUESVE

Synimi kryesor i vëzhgimit në klasë gjatë orëve mësimore është rritja e efektivitetit të mësimdhënies dhe të nxënësve të nxënësve. Kjo përfshin vëzhgimin e aspekteve të ndryshme të mësimdhënies, të tilla si: metodat mësimore, menaxhimin e klasës, angazhimin e nxënësve dhe praktikën e vlerësimit të tyre. Vëzhgimi në klasë gjatë orëve mësimore dhe mbështetja e mësuesve janë komponentë thelbësorë të punës së mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë në shkollë. Ato jo vetëm ndihmojnë në sigurimin e praktikave efektive të mësimdhënies, por nga ana tjetër ofrojnë mundësi për rritje profesionale të mësuesve. Koordinator i sigurimit të cilësisë gjatë vëzhgimit të orëve mësimore ka rol mbështetës, orientues, këshillues dhe ndihmues, kurse drejtuesit e institucionit arsimor kanë detyrimin që të realizojë vëzhgime të orëve mësimore për të vlerësuar performancën e mësuesit.

Disa aspektet kryesore të këtij procesi përmbajnë:

8.1 Treguesit kryesorë të vëzhgimit në klasë dhe të mbështetjes së mësuesve

- ✓ Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies.
- ✓ Përmirësimi i rezultateve të të nxënësve të nxënësve.
- ✓ Ofrimi i komenteve dhe i sugjerimeve konstruktive për mësuesit.
- ✓ Identifikimi i fushave për zhvillim profesional.
- ✓ Zbatimi me efektivitet i kurrikulës.
- ✓ Promovimi i praktikave më të mira të mësimdhënies.
- ✓ Inkurajimi i vetëreflektimit të mësuesit duke krijuar një mjedis mbështetës.

8.2 Fazat kryesore të vëzhgimit të orës së mësimit

- ✓ *Takimi para vëzhgimit:* Diskutimi i planifikimit ditor, i rezultateve të të nxënit, i çështjeve specifike për të cilat mësuesi dëshiron komente.
- ✓ *Vëzhgimi i orës së mësimit:* Mbledhja e të dhënave për praktikën e mësimit dhe arritjet e nxënësve në fund të orës së mësimit.
- ✓ *Takimi pas vëzhgimit:* Reflektimi nga procesi mësimor. Dhënia e reagimeve konstruktive. Vendosja e prioritetëve për përmirësim.
- ✓ *Mbështetje në vijim:* Ofrimi i burimeve dhe i mundësive për zhvillim të vazhdueshëm profesional.
- ✓ *Monitorimi për progresin* e planifikuar sipas një afati të përcaktuar.
- ✓ *Dokumentimi:* Ruajtja e vëzhgimeve dhe e vlerësimeve për vëzhgimet e realizuara.

8.3 Modele të vëzhgimit të orës së mësimit

- ✓ *Vëzhgim i plotë* me të gjitha elementet gjatë gjithë orës së mësimit.
- ✓ *Vëzhgim i pjesshëm*, i shkurtër për një çështje të caktuar (mund të jetë edhe pa takimin fillestar para vëzhgimit).
- ✓ *Vëzhgime të shpeshta* për mësuesit e rinj, jo vetëm nga mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë, por edhe me kolegë me më shumë eksperiencë si mësues.
- ✓ *Vëzhgim i bazuar në video:* Mësuesit regjistrojnë vetë mësimit e tyre për vetë-reflektim ose rishikim nga kolegët. Ky lloj vëzhgimi lejon analiza dhe diskutime të rëndësishme edhe nga kolegët.

8.4 Format i vëzhgimit të orës së mësimit

Formati i vëzhgimit të orës mësimore (shtojca nr.2) apo formati i vëzhgimit të orës së projektit kurrikular (shtojca nr. 3) përmbajnë rubrikat e mëposhtme:

- ✓ *Informacion të përgjithshëm:* Emri i mësuesit, lënda, klasa, tema, data, ora.
- ✓ *Planifikimi i orës mësimore*, i rezultateve të të nxënit dhe i komponentëve të tjerë për realizimin e këtyre rezultateve.
- ✓ *Mjedisi i të nxënit*, angazhimi i nxënësve, organizimi i nxënësve, komunikimi dhe klima pozitive.



- ✓ *Metodat mësimore* për zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, llojet e veprimtarive të nxënësve, menaxhimi i klasës, menaxhimi i kohës, mësimi i diferencuar.
- ✓ *Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve*, pikat e forta dhe pikat për përmirësim, teknika të ndryshme të vlerësimit.
- ✓ *Përdorimi i mjeteve mësimore*, përdorimi i teknologjisë, përdorimi i platformave interaktive.

8.5 Sugjerime për komente konstruktive pas vëzhgimeve

- ✓ Krijimi i një atmosfere pozitive.
- ✓ Përdorimi i tonit miqësor dhe mbështetës.
- ✓ Ndërgjegjësimi i mësuesit se qëllimi është rritja, jo gjykimi.
- ✓ Përdorimi i një mjedisi privat dhe komod për takimin.
- ✓ Fillimi me vetë-reflektime të mësuesit për orën mësimore.
- ✓ Nisja me reagimet pozitive të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.
- ✓ Adresimi i çështjeve për përmirësim.
- ✓ Përfundimi me inkurajim dhe përforsim pozitiv.
- ✓ Shmangja e përgjithësimeve si “mirë” ose “në përgjithësi ka nevojë për përmirësim”.
- ✓ Përqendrimi i diskutimit në punën dhe në sjelljet, jo në personalitet.
- ✓ Përqendrimi në 2-3 çështje kyç për përmirësim duke shpjeguar pse disa praktika janë efektive ose disa të tjera kanë nevojë për përmirësim.
- ✓ Bërja e pyetjeve sqaruese për të kuptuar sfidat.
- ✓ Përdorimi i teknologjisë kur është e përshtatshme, nëse është përdorur regjistrim ose video, (rishikohen momentet kryesore së bashku). Përdorimi i mjeteve digjitale për të ndarë shënimet dhe reflektimet e vëzhgimit.

8.6 Shembuj pyetjesh dhe komentesh për analizën dhe diskutimin e vëzhgimit

- ✓ Si mendoni se shkoi mësimi?
- ✓ Cilat mendoni se ishin pikat e forta të mësimit tuaj?
- ✓ Nëse do të mund ta jepnit përsëri këtë mësim, çfarë do të bënit ndryshe?
- ✓ Kur përdorët metodën gjatë diskutimit, vura re se 90% e nxënësve ishin të angazhuar në mënyrë aktive. Pse?

- ✓ Në vend të shprehjes “Je i çorganizuar”, thuaj “Kalimi midis aktiviteteve zgjati më shumë se sa ishte planifikuar, gjë që zvogëloi kohën për mësimin kryesor”.
- ✓ Komentet fillojnë “Nga këndvështrimi im” për të shmangur keqkuptime.
- ✓ Përdorni komente, si “Vura re se disa nxënës në rreshtin e fundit dukeshin të hutuar dhe jo aktivë gjatë diskutimeve të mësimin të ri”.
- ✓ Përdorni pyetje të hapura: “Si mund ta rrisni pjesëmarrjen e nxënësve në diskutime gjatë gjithë orës mësimore?”.
- ✓ “Le të vendosim një rezultat të nxëni dhe të diskutojmë tri strategji vlerësimi formues në orët mësimore tuaja javën e ardhshme”.
- ✓ “Po ju tregoj një material mbi punën e diferencuar që mund të jetë i dobishëm për nxënësit me vështirësi në të nxënë në klasën tuaj”.
- ✓ “Kam vënë re se ju i drejtoheni të njëjtëve nxënës në 70% të rasteve gjatë pyetjeve dhe përgjigjeve në orën e mësimin.”.
- ✓ Etj.

Duhet mbajtur gjithmonë parasysh se qëllimi është krijimi i një mjedisi mbështetës dhe bashkëpunues që inkurajon përmirësimin e vazhdueshëm të mësuesit. Është e rëndësishme që mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë të përshtatë qasjen e tij ndaj nevojave individuale të secilit mësues dhe nivelit të përvojës të tij. Reagimet efektive duhet t'i bëjnë mësuesit të ndihen të motivuar dhe të pajisur për të përmirësuar praktikën e tyre të mësimdhënies.

8.7 Kriteret e vlerësimit të vëzhgimit

Kriteret e vlerësimit për vëzhgimin e mësimin ofrojnë një kuadër të strukturuar për të vlerësuar aspekte të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënit. Këto kriteret ndihmojnë në sigurimin e qëndrueshmërisë dhe objektivitetit në procesin e vëzhgimit.

- a) Kriteret e vlerësimit të orës mësimore paraqiten në shtojcën nr.4.
- b) Kriteret e vlerësimit të projektit lëndor paraqiten në shtojcën nr. 5.

IX. ANALIZA E REZULTATEVE TË NXËNËSVE PËR PËRMIRËSIMIN E ARRITJEVE TË TYRE

Analiza e rezultateve të nxënësve për të përmirësuar arritjet e tyre është një përgjegjësi kritike e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. Kjo përgjegjësi përfshin ekzaminimin sistematik të të dhënave, identifikimin e tendencave dhe zbatimin e strategjive për të përmirësuar performancën e përgjithshme të nxënësve. Kjo është një përgjegjësi relativisht e re në shkollat tona dhe një mësues koordinator i sigurimit të cilësisë mund t'i qaset kësaj detyre në disa mënyra gjithëpërfshirëse:

9.1 Aksesi për lloje të ndryshme të të dhënave

Stafi drejtues i shkollës i krijon koordinatorit të sigurimit të cilësisë akses në të dhënat dhe në statistikat e shkollës, pa cenuar të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale si p.sh.:

- Performanca mësimore e nxënësve (pikët e testeve të periudhave, notat e vlerësimit të vazhduar, vlerësimet e projektit, vlerësime lëndore etj.).
- Të dhënat për orientimin për karrierë.
- Frekuentimi në shkollë.
- Përfshirja në aktivitete jashtëshkollore, klube etj.
- Të dhëna të tjera të nevojshme.

9.2 Analiza e të dhënave të mbledhura

- Analiza diagnostikuese.
- Kryerja e analizave të rregullta, gjithëpërfshirëse të të dhënave të nxënësve.
- Vlerësimi i tendencave e përgjithshme të performancës së nxënësve.
- Identifikimi i mangësive të arritjeve midis grupeve/ klasave/ lëndëve të ndryshme të nxënësve.
- Analiza e progresit me kalimin e kohës, në mënyrë krahasuese.
- Ekzaminimi i korrelacionit midis faktorëve të ndryshëm (p.sh., frekuentimi dhe notat).
- Përdorimi i metodave të analizës sasiore dhe cilësore.
- Përdorimi i mjeteve statistikore dhe softuer për analiza të ndryshme (SMIP).

9.3 Raportimi dhe komunikimi

- Ofrohet informacion i nevojshëm për të gjithë aktorët.
- Paraqiten rregullisht gjetjet tek stafi drejtues, mësuesit duke theksuar njohuritë kryesore dhe fushat për përmirësim.

9.4 Metodatat në analizën e të dhënave për përmirësimin e arritjeve të nxënësve

Qëllimi kryesor i këtij procesi është që analiza e të dhënave të bëhet pjesë e vlefshme, e integruar e praktikës profesionale të mësuesve dhe jo një barrë shtesë. Duke nxitur angazhimin dhe pronësinë në procesin e të dhënave, mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë **mund** të krijojnë qasje më efektive dhe të qëndrueshme ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të mësuesve.

Metoda e analizës së të dhënave	Shembuj
Statistika përshkruese	
Llogaritja e mesatares, mesores, modës, përqindjes etj.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Llogaritja e rezultatit mesatar (mesatare) të testit për një klasë për të vlerësuar performancën e përgjithshme të nxënësve të saj. ▪ Nota mesatare e klasës, shkollës ose nota mesatare për lëndë të caktuara. ▪ Gjetja e rezultatit mesatar për të identifikuar mesoren e arritjeve të nxënësve. ▪ Rast i përdorimit: <i>Një mësues matematike llogarit këto statistika për një test në kapitullin e algjebërës. Ai zbulon se kalueshmëria është 75%, mesatarja është 7,8 dhe ka një gjerësi pikësh prej 15 pikësh. Mësues merr në konsideratë strategji të diferencuara mësimore për nxënësit me rezultate të ulëta në kapitullin e algjebërës.</i>
Llogaritja e përqindjes.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kalueshmëria në total, sipas klasave, mësuesve në gjuhë shqipe, në gjuhë të huaj dhe në matematikë. ▪ Kalueshmëria krahasuar me periudhën ose me vitin e kaluar. ▪ Kalueshmëria krahasuar me provimet kombëtare (p.sh., PKAB me VANAF). ▪ Arritjet e nxënësve me nevoja të veçanta.

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Arritjet e nxënësve të klasave të pesta, të nënta dhe të dymbëdhjeta.
Analiza e trendit dhe tendenca	
<p>Ekzaminimi i të dhënave në mënyrë krahasuese për të identifikuar ndryshimet nga një periudhë (ose vit) në tjetrën.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Monitorimi i performancës mesatare të klasës në vlerësimet periodike gjatë gjithë vitit shkollor. ▪ Monitorimi i notave të nxënësve të veçantë përgjatë periudhave mësimore dhe analizimi i të dhënave krahasuese të tyre. ▪ Rasti i përdorimit: <i>Një mësues kujdestar gjurmon notat e një nxënësi në lëndën e gjuhës shqipe gjatë tri viteve shkollore, duke vënë re një rënie graduale në performancën gjuhësore. Kjo nxit një diskutim me nxënësin dhe mësuesit e gjuhës shqipe për të identifikuar dhe për të trajtuar çdo çështje themelore duke konsideruar masat për përmirësimin e rezultateve të këtij nxënësi.</i>
Analiza krahasuese	
<p>Krahasimi i të dhënave të shkollës kundrejt të dhënave në nivel ZVAP-je dhe në nivel kombëtar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krahasimi i rezultateve të testit në nivele të ndryshme arsimore në një lëndë të caktuar. ▪ Matja e performancës së shkollës kundrejt mesatareve në nivel ZVAP-je ose në nivel kombëtar. ▪ Rasti i përdorimit: <i>Një drejtor krahason rezultatet e gjuhës shqipe në arsimin fillor, duke vënë re se rezultatet e klasave të pesta janë dukshëm më të ulëta dhe nën mesataren e shkollave të tjera të ZVAP-së. Kjo çon në një fokus për përmirësimin e metodave të përdorura në lëndën e gjuhës shqipe në arsimin fillor dhe ofrimin e mbështetjes shtesë për ata mësues.</i>
Analiza e grupit	
<p>Gjurmimi i një grupi të caktuar nxënësish me kalimin e viteve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndiqet performanca e një klase p.sh., nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të (ose në AML). ▪ Analizimi i rezultateve për nxënësit që hynë në shkollën e mesme. ▪ Rasti i përdorimit: <i>Një shkollë 9 - vjeçare gjurmon një grup nxënësish që kanë marrë orë përforcimi shtesë në lëndën e matematikës në</i>



	<p><i>klasën e 6-të. Duke analizuar performancën e tyre deri në klasën e 9-të, mësuesit mund të vlerësojnë ndikimin afatgjatë të ndërhyrjes së hershme në këtë lëndë dhe të analizojnë rezultatet në provimin kombëtar të matematikës.</i></p>
Tabela e kryqëzuar	
<p>Shqyrtimi i korrelacionit midis dy ose më shumë variablave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizimi i lidhjes midis frekuentimit dhe performancës mësimore të nxënësve. ▪ Rasti i përdorimit: <i>Një mësues kujdestar krijon një tabelë të kryqëzuar të frekuentimit të nxënësve dhe notës mesatare të tyre. Ata zbulojnë një korrelacion, i cili jep informacion për të marrë masa për frekuentimin e nxënësve në shkollë.</i>
Vlerësimi i efektivitetit të kurrikulës	
<p>Vlerësimi i efektivitetit të një kurrikule të re.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Matja e rezultateve pre - testit dhe post testit pas zbatimit të kurrikulës. ▪ Kryerja e anketave me nxënësit dhe me mësuesit. ▪ Krahasimi i performancës para dhe pas ndryshimit të kurrikulës dhe analizimi i reagimeve. ▪ Përditësimi i metodave dhe/ose strategjisë së zbatimit të kurrikulës.

Kur zbatohen këto metoda, është thelbësore që:

- Të sigurohet saktësia dhe besueshmëria e të dhënave.
- Të merren parasysh konteksti dhe faktorët e tjerë që lidhen me të dhënat.
- Të përdoren metoda të shumta për një kuptim gjithëpërfshirës.
- Të përfshihen mësuesit në interpretimin e rezultateve.
- Të përdoren njohuritë për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënit.
- Të ruhet privatësia e nxënësve dhe të respektohen rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Mos harroni, qëllimi i analizës së të dhënave nuk është vetëm të gjenerojë statistika, por të bëhet interpretimi i tyre dhe të ndikohet në marrjen e vendimeve që përmirësojnë rezultatet e të nxënësve.

Qasja më efektive shpesh përfshin kombinimin e metodave të shumta dhe gjithmonë lidhjen e analizave me njohuri praktike dhe të zbatueshme për mësuesit.

9.5 Lidhja ndërmjet rezultateve të analizës dhe veprimtarisë që duhet të organizojë mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë shembuj gjetjesh nga analiza e të dhënave dhe veprimtaritë që mund të ndërmarrë koordinatori i sigurimit të cilësisë për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve.

Shembuj gjetjesh të analizës së të dhënave	Shembuj veprimtarish për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve
<i>Të dhënat tregojnë se nxënësit vazhdimisht kanë rezultate të dobëta në tematika të caktuara të matematikës, siç është arsyetimi algjebrik.</i>	Mësuesit mund të kenë nevojë për zhvillim profesional të përqendruar në strategji efektive për mësimin e koncepteve algjebrike ose në të kuptuarit e argumenteve të zakonshme në këtë fushë ose në zbatimin e këtyre koncepteve në situata të jetës reale.
<i>Të dhënat tregojnë se nxënësit performojnë mirë në pyetjet me zgjedhje të shumfishta, por kanë vështirësi me pyetje të hapura.</i>	Mësuesit mund të kenë nevojë për zhvillim profesional në hartimin e llojeve të ndryshme të pyetjeve dhe mësimdhënien e aftësive të menduarit të nivelit më të lartë.
<i>Të dhënat e angazhimit të nxënësve tregojnë pjesëmarrje më të ulët në orë mësimore që nuk përfshijnë teknologjinë.</i>	Mësuesit mund të përfitojnë nga trajnimi për integrimin efektiv të teknologjisë digjitale për të rritur angazhimin e nxënësve në orët e tyre mësimore.
<i>Të dhënat zbulojnë se nxënësit që kanë vështirësi në gjuhën shqipe vazhdimisht kanë performancë të ulët në të gjitha lëndët.</i>	Mësuesit mund të kenë nevojë për zhvillim profesional mbi strategjitë për mbështetjen e nxënësve në gjuhën shqipe pavarësisht lëndës së tyre.
<i>Të dhënat nga frekuentimi tregojnë një rritje të lënive të orëve të mësimit, që lidhet me uljen e performancës mësimore të nxënësve.</i>	Mësuesit mund të përfitojnë nga trajnimi mbi strategjitë e menaxhimit të sjelljes pozitive, krijimit të klimës pozitive dhe mjediseve mbështetëse në klasë.

<i>Të dhënat e mangësive të arritjeve tregojnë se grupe të caktuara demografike nuk kanë performancë të qëndrueshme.</i>	Mësuesit mund të përfitojnë nga trajnimi mbi praktikën e diversitetit kulturor për të angazhuar më mirë të gjithë nxënësit.
<i>Të dhënat tregojnë se nxënësit kanë dëshirë të punojnë me projekte afatgjata dhe punë të pavarur.</i>	Mësuesit mund të përfitojnë nga zhvillimi profesional në zbatimin e strategjive efektive të të nxënësve të bazuara në projekte.
<i>Të dhënat tregojnë se nxënësit me nevoja të veçanta nuk po bëjnë përparimin e pritur në klasat e tyre.</i>	Mësuesit mund të kenë nevojë për zhvillim profesional në praktikën e arsimit gjithëpërfshirës dhe mësimin e diferencuar për nxënësit me nevoja të veçanta.
<i>Të dhënat e angazhimit zbulojnë rënie të motivimit të nxënësve, ndërsa viti shkollor është në mes të tij.</i>	Mësuesit mund të përfitojnë nga trajnimi mbi strategjitë për të ruajtur motivimin e nxënësve dhe për të krijuar mësim tërheqës.
<i>Të dhënat tregojnë se nxënësit kanë mangësi në zbatimin në situata të jetës reale, të aftësive të fituara në lëndë të ndryshme.</i>	Mësuesit mund të kenë nevojë për zhvillim profesional për mësimdhënien e aftësive të transferueshme në situata kontekstuale nga jeta reale.
<i>Të dhënat e vlerësimit tregojnë se nxënësit shkëlqejnë në memorizimin e njohurive, por kanë vështirësi me detyrat e analizës, vlerësimit si dhe me aftësitë e tjera të të menduarit të nivelit të lartë.</i>	Mësuesit mund të përfitojnë nga trajnimi për përfshirjen e aftësive të të menduarit të nivelit të lartë në mësimdhënien e përditshme.
<i>Të dhënat tregojnë se nxënësit vazhdimisht mbivlerësojnë ose nënvlerësojnë performancën e tyre.</i>	Mësuesit mund të përfitojnë nga zhvillimi profesional në mësimdhënien e strategjive efektive të vetëvlerësimit.
Etj.	Etj.

Mbani parasysh se qëllimi është të përdoren të dhënat për të identifikuar fushat ku zhvillimi profesional mund të ketë ndikimin më të rëndësishëm në rezultatet e të nxënësve. Kjo qasje siguron që ZHVP-ja të jetë e bazuar në nevoja dhe e lidhur drejtpërdrejt me përmirësimin e praktikës mësimore dhe të arritjeve të nxënësve.

9.6 Sfidat e angazhimit të mësuesve në analizën e të dhënave

Mësuesit mund të hasin sfida kur angazhohen në analizën e të dhënave, si pjesë e nismave të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. Më poshtë janë përmbledhur disa sfida dhe disa këshilla për kapërcimin e tyre, për mësuesin koordinator të sigurimit të cilësisë.

Sfida	Këshilla
Mungesa e kohës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kushtojini kohë specifike në planin vjetor dhe në orarin e punës së mësuesit, analizës së të dhënave. ▪ Përdorni ditët e zhvillimit profesional për mbledhjen, përpunimin dhe vlerësimin e të dhënave. ▪ Caktoni një ditë/ datë, si p.sh.: “Takimi për përcaktimin/ mbledhjen/diskutimin e të dhënave”, çdo muaj ose çdo tremujor, ku mësuesit të përqendrohen vetëm në këtë detyrë. ▪ Siguroni kohën e nevojshme për të lejuar sesione të analizës së të dhënave bashkëpunuese.
Mbledhja e të dhënave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Filloni me grupe të vogla për mbledhjen e të dhënave. ▪ Jepuni përparësi çështjeve të të dhënave më të zbatueshme. ▪ Përdorni mjetet digjitale për përpunim. ▪ Siguroni pyetje të qarta udhëzuese për të lehtësuar analizën.
Mangësi në leximin dhe në interpretimin e të dhënave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ofroni trajnime të vazhdueshme në interpretimin dhe analizën e të dhënave (përfshirë edhe SMIP-in). ▪ Krijoni një program mentorimi duke çiftuar mësuesit me aftësi shumë të mira për të dhënat me ata me më pak përvojë. ▪ Zhvilloni udhëzues tutorialë për përdoruesit, lidhur me detyrat e analizës së të dhënave. ▪ Përdorni panele të thjeshtuara të të dhënave që nxjerrin në pah matjet kryesore.
Frika nga vlerësimi ose gjykimi	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Inkurajoni një mentalitet të përmirësimit të vazhdueshëm dhe rritjes profesionale.

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përqendrohuni në të dhënat e nivelit të shkollës ose të klasës si progres sesa në të dhënat individuale të mësuesit. ▪ Përdorni të dhënat për të përgëzuar përparimin dhe për të identifikuar fushat për mbështetje, jo masa ndëshkuese. ▪ Përfshini mësuesit në përcaktimin e qëllimeve të bazuara në të dhëna për veten dhe nxënësit e tyre
<p>Mungesa e besimit në saktësinë ose në rëndësinë e të dhënave</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Jini transparent në lidhje me metodat dhe burimet e mbledhjes së të dhënave. ▪ Përfshini mësuesit në diskutime se cilat të dhëna duhet të mblidhen dhe të analizohen. ▪ Kombinoni të dhënat sasiore me perceptimet cilësore nga mësuesit. ▪ Rishikoni dhe përditësoni rregullisht proceset e mbledhjes së të dhënave bazuar në reagimet e mësuesve.
<p>Rezistenca ndaj ndryshimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Filloni me adoptuesit e hershëm dhe lëri të ndajnë sukseset. ▪ Siguroni zgjedhje në mënyrën se si mësuesit angazhohen me të dhënat (p.sh., metoda të ndryshme analize). ▪ Tregoni shembuj konkretë se si analiza e të dhënave ka çuar në përmirësimin e rezultateve të nxënësve. ▪ Trajtoni shqetësimet hapur dhe përfshini mësuesit që shfaqin rezistencë në gjetjen e zgjidhjeve.
<p>Mungesa e aftësive teknologjike</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ofroni seanca trajnimi praktike për sistemet e menaxhimit të të dhënave (përfshirë SMIP-in). ▪ Krijoni video tutoriale për detyrat e zakonshme të analizës së të dhënave. ▪ Siguroni mbështetje të vazhdueshme teknike ose caktoni një "koordinatör të teknologjisë së të dhënave" për mësuesit (mund të jetë koordinatori i SMIP-it).
<p>Mungesa e angazhimit për të bashkëpunuar</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Organizoni sesione të analizës së të dhënave ndërkurrikulare. ▪ Përdorni rubrika të përbashkëta ose kritere vlerësimi në të gjitha lëndët, kur është e mundur. ▪ Lehtësoni diskutimet se si tema të ndryshme ndikojnë njëra-tjetrën.

<p><i>mes ekipeve lëndore</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijoni ekipe të dhënash ndërdisiplinore për të identifikuar tendencat ndërmjet ekipeve lëndore.
<p><i>Vështirësi në përkthimin e njohurive të të dhënave për ZHVP-në e tyre</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijoni një proces të qartë për kalimin nga analiza e të dhënave në planifikimin e ZHVP-së ▪ Përfshini mësuesit në identifikimin e nevojave të ZHVP-së, duke u bazuar në tendencat e të dhënave. ▪ Përdorni një përzierje të mundësive të ZHVP-së për të gjithë mësuesit dhe të personalizuar për të adresuar nevoja të ndryshme. ▪ Vlerësoni rregullisht ndikimin e ZHVP-së në çështjet e të dhënave.
<p><i>Shqetësimet për privatësinë e të dhënave</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Siguroni udhëzime të qarta për konfidencialitetin dhe përdorimin e të dhënave. ▪ Përdorni të dhëna anonime për diskutime në grup, aty ku është e përshtatshme. ▪ Siguroni ruajtjen e sigurt të të dhënave dhe protokollet e aksesit të tyre. ▪ Informoni mësuesit për rregulloret dhe praktikat më të mira për mbrojtjen e të dhënave.

X. DOKUMENTACIONI QË MBAN MËSUESI KOORDINATOR I SIGURIMIT TË CILËSISË

Koordinatori i sigurimit të cilësisë, për të kryer në mënyrë sa më cilësore dhe efektive përgjegjësitë e tij, duhet të mbajë një dosje gjithëpërfshirëse me dokumente të ndryshme për të menaxhuar dhe për të përmirësuar zhvillimin profesional të mësuesve, arritjet e nxënësve si dhe zbatimin e kurrikulës dhe risive të saj. Baza ligjore përditësohet vazhdimisht sipas akteve ligjore të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, ASCAP, si dhe institucionet e varësisë së MAS-it.

Në mënyrë të kategorizuar sipas dimensioneve përkatëse, dokumentet thelbësore përmbledhen si më poshtë:

- a) Raporti kombëtar i identifikimit të nevojave të punonjësve arsimorë.
- b) Programi kombëtar i Zhvillimit Profesional të Mësuesve.
- c) Standardet profesionale të mësuesit.
- d) Standardet profesionale të përdorimit të TIK nga mësuesit.
- e) Udhëzuesi i akreditimit dhe i njohjes së aktiviteteve të zhvillimit profesional.
- f) Informacioni për nevojat e mësuesve për zhvillimin profesional në nivel shkolle.
- g) Plani i vjetor i koordinatorit të sigurimit të cilësisë, i cili përfshin kalendarin vjetor me veprimtaritë e zhvillimit profesional të mësuesve, vëzhgimet në klasë, veprimtaritë për përmirësimin e arritjeve të nxënësve etj. (formati shtojca nr. 1), i hartuar në bashkëpunim me stafin drejtues dhe me kryetarët e ekipeve lëndore.

10.1 Dokumente për dimensionin zhvillimin të vazhdueshëm profesional të mësuesve

- a) Materialet e aktiviteteve të ZHVP-së, të cilat përfshijnë: prezantimet e takimeve, agjenda e takimeve, fletëpalosje (nëse ka), raportet e aktiviteteve të ZHVP-së etj. (model shtojca nr.6).
- b) Certifikatat ose dëshmitë e mësuesve (fotokopje) për aktivitetet e ZHVP-së të kryera jashtë shkollës brenda një viti shkollor.
- c) Certifikata të kualifikimit të mësuesve për fazat e ndryshme të karrierës (fotokopje).
- d) Instrumentet e vëzhgimit dhe vlerësimit, si: instrumenti i vëzhgimit të orës së mësimin me vlerësimin, instrumenti i vëzhgimit të orës së projektit kurrikular me vlerësimin, vlerësimi.

- e) Informacion për progresin e mësuesit në zhvillimin profesional dhe në zhvillimin e procesit mësimor.
- f) Modele të pyetësorëve/anketave pas aktiviteteve të zhvillimit profesional (shtojca nr.7).
- g) Praktikant më të mira të mësuesve: Prezantime që sjellin risi, modele orësh të zhvilluara që sjellin përmirësim të rezultateve të nxënësve, modele projektsh kurrikulare që sjellin risi, raste studimore të praktikave efektive të mësimdhënies, etj.
- h) Projekte me organizata jofitimprurëse (nëse ka), mundësi granti për zhvillimin e mësuesve.

10.2 Dokumente për dimensionin e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit të arritjeve të nxënësve

- a) Të dhënat e performancës së nxënësve që do të analizohen gjatë vitit shkollor bazuar në objektivin/at e planit vjetor të shkollës: rezultatet e testimit të lëndëve “Gjuhë shqipe” ose “Matematikë”, të krahasuara për tri periudhat dhe raportet përkatëse të rezultateve.
- b) Të dhëna nga vlerësimi i brendshëm i shkollës.

10.3 Dokumente për dimensionin e planifikimit dhe të zhvillimit të kurrikulës në institucionin arsimor

- a) Udhëzuesit kurrikularë sipas niveleve arsimore ose sipas lëndëve, të hartuara nga ASCAP.
- b) Menu e moduleve kurrikulare të hartuara nga ASCAP, si dhe lista e moduleve kurrikulare të hartuara në nivel shkolle.
- c) Programet orientuese për provimet kombëtare.
- d) Modele projektsh kurrikulare dhe ndërkurrikulare, efektive dhe cilësore.
- e) Modele të orëve mësimore, efektive dhe cilësore.

10.4 Raporti vjetor i realizimit të veprimtarive

Raporti vjetor për realizimin e aktiviteteve është një dokument sintetik që përmbledh progresin, arritjet dhe sfidat e përgjegjësive të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. Në të detajohen në mënyrë specifike aktivitetet e realizuara për sigurimin e cilësisë së institucionit arsimor dhe përmirësimet e ndërmarra gjatë vitit shkollor. Në raportin vjetor përfshihen:

- A) Vizioni i institucionit arsimor.
- B) Përparësitë i institucionit arsimor.

- C) Objektivi/at vjetore të institucionit arsimor.
- D) Objektivat e detajuara të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.
- E) Pikat kryesore të arritjeve për secilin prej dimensioneve, sipas veprimtarive të planifikuara në planin vjetor dhe të realizuara gjatë vitit shkollor.
- F) Veprimtaritë e realizuara gjatë vitit shkollor për secilin prej dimensioneve:
- ✓ **Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve (i brendshëm dhe i jashtëm).**
 - Përmbledhja e tematikave kryesore të nevojave të mësuesve për vitin shkollor.
 - Numri i mësuesve që kanë marrë pjesë në aktivitete të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, të ndara sipas llojeve të tyre.
 - Përmbledhja e tematikave të aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional.
 - Përputhshmëria e tematikave të aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional me nevojat e mësuesve për vitin shkollor përkatës.
 - Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional në mësimdhënie dhe në rezultatet e nxënësve.
 - Vëzhgimet e realizuara në klasë, numri dhe llojet e vëzhgimeve të kryera.
 - Gjetjet kryesore nga vëzhgimet e realizuara në klasë.
 - ✓ **Sigurimi i cilësisë dhe përmirësimi i arritjeve të nxënësve.**
 - Analiza e të dhënave nga arritjet e nxënësve.
 - Përmbledhja e gjetjeve kryesore nga analiza e të dhënave për performancën e nxënësve.
 - Përmbledhja e anketave ose e pyetësorëve të realizuar gjatë vitit shkollor (nëse ka).
 - Identifikimi i mangësive të nxënësve në lëndë specifike (nëse ka).
 - Veprimet e ndërmarra në përgjigje të gjetjeve kryesore.
 - ✓ **Planifikimi dhe zhvillimi i kurrikulës.**
 - Orët mësimore të hapura, numri i tyre dhe përmbledhja e tematikave kryesore dhe praktikave më të mira.
 - Vlerësimi i përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe ndikimi në rezultatet e nxënësve.
 - Modulet kurrikulare të realizuara në kurrikulën në bazë shkolle, numri i nxënësve që kanë përfituar.

G) Sfidat kryesore të realizimit të veprimtarive, pengesat që hasen në zbatimin e iniciativave cilësore dhe praktikrat për kapërcimin e tyre.

H) Rekomandimet për vitin e ardhshëm shkollor dhe çështjet për përmirësim.

Raporti vjetor duhet të përshtatet me përmbushjen e nevojave të stafit drejtues të institucionit arsimor dhe “aktorëve” të tjerë të përfshirë në procesin e përmirësimit të cilësisë. Ky raport duhet të jetë i mirëstrukturuar, i lehtë për t'u lexuar dhe tërheqës vizualisht. Ai shërben jo vetëm si një regjistrim i aktiviteteve të vitit, por edhe si një mjet komunikimi për mësuesit dhe palët e interesuara, duke përfshirë anëtarët e bordit, punonjësit e njësive arsimore vendore etj.

***Shënim.** Përmbajtja e raportit vjetor të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë mund të ndryshojë në bazë të objektivave të përcaktuara për vitin shkollor, të kontekstit specifik të institucionit arsimor, të qëllimeve dhe nevojave të palëve të interesuara. Gjithashtu, të gjitha të dhënat dhe informacionet e përfshira në raportin vjetor duhet të jenë në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, me kodin e etikës së mësuesit, kuadrin ligjor në arsimin parauniversitar dhe me rregulloren e institucionit arsimor.*

Të gjitha dokumentet e përshkruara në kapitullin XIII duhet të jenë të mirorganizuar, të përditësuara dhe të rishikohen rregullisht për t'u siguruar që ato pasqyrojnë praktikrat më të mira aktuale, standardet arsimore dhe nevojat specifike të nxënësve dhe të komunitetit të institucionit arsimor. Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë duhet gjithashtu të sigurojë që këto dokumente të jenë lehtësisht të aksesueshme për mësuesit përkatës dhe se mund të përmirësohen nga komentet dhe sugjerimet e mësuesve. **Është e rëndësishme të ruhen përgjatë një viti shkollor si kopjet digjitale ose fizike aty ku është e përshtatshme, duke siguruar privatësinë dhe sigurinë e të dhënave në çdo kohë.**

***Shënim.** Dokumentet specifike mund të ndryshojnë në varësi të kontekstit dhe të specifikave të institucionit arsimor. Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë duhet ta përshtatë këtë listë dokumentesh për të përmbushur nevojat dhe kërkesat specifike të institucionit të tij arsimor.*

XI. ZHVILLIMI I VAZHUESHËM PROFESIONAL I MËSUESIT KOORDINATOR TË SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMI I PERFORMANCËS

11.1 Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe personal për mësuesin koordinator të sigurimit të cilësisë është thelbësor për ruajtjen dhe për përmirësimin e cilësisë së punës së tij, por jo vetëm. Ai duhet të jetë vazhdimisht i përditësuar me të rejat më të fundit në fushën e edukimit, me kërkimet dhe me praktikat më të mira, duke ndikuar kështu në përmirësimin e cilësisë në institucionin arsimor. Ai duhet të demonstrojë përmirësim të aftësive për të menaxhuar dhe për të zbatuar në mënyrë efektive proceset e sigurimit të cilësisë, të demonstrojë se edhe ai vetë është i përkushtuar dhe i angazhuar për rritjen profesionale dhe personale, duke rritur besueshmërinë e tij para mësuesve.

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional e pajis mësuesin koordinator të sigurimit të cilësisë me njohuri dhe me mjete për të marrë vendime të informuara në lidhje me strategjitë e përmirësimit të cilësisë së institucionit arsimor, ofron mundësi për t'u lidhur me kolegët dhe me ekspertët e fushës dhe e ekspozon atë ndaj ideve dhe qasjeve të reja teknologjike që mund të përshtaten me kontekstin e tyre shkollor.

Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë merr pjesë në të gjitha aktivitetet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të organizuara nga ASCAP dhe nga institucione të tjera që lidhen me realizimin e përgjegjësisë së tij.

Ai merr pjesë në rrjetet profesionale të mësuesve koordinatorë të sigurimit të cilësisë (në rastet kur është e mundur të krijohet rrjeti profesional).

Gjithashtu mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë merr pjesë në:

- trajnime /seminare/ konferenca të specializuara për zhvillimin profesional të mësuesve, cilësinë e arritjeve të nxënësve, zbatimin e kurrikulës etj.
- grupe pune për diskutime dhe hartim materialesh në mbështetje të mësuesve.
- kurse online, ëebinare për cilësinë në arsim.
- projekte kombëtare apo ndërkombëtare për të përmirësuar cilësinë e arsimit në institucionin arsimor.
- kurse për përmirësimin e aftësive digjitale.
- vizita në shkolla të tjera për të marrë dhe për të shkëmbyer eksperiencën.

11.2 Vlerësimi i performancës së mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë

Vlerësimi i performancës së një mësuesi koordinator për sigurimin e cilësisë ndjek një format të bazuar në përgjegjësitë e tij. Format i vlerësimit të performancës përmban rubrikat:

- a) Informacion i përgjithshëm për mësuesin koordinator të sigurimit të cilësisë.
- b) Objektivat vjetore të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.
- c) Vlerësimi i performancës për secilin objektivi me katër nivele të performancës:
 - **Niveli 4.** Shumë mirë, kur objektivi është arritur në masën 90-100%.
 - **Niveli 3.** Mirë, kur objektivi është arritur në masën 70-89 %.
 - **Niveli 2.** Mjaftueshëm, kur objektivi është arritur në masën 50% – 69%.
 - **Niveli 1.** Dobët, kur objektivi është arritur në masën më pak se 50%.
- d) Vlerësimi i performancës për secilën nga përgjegjësitë sipas dimensioneve përkatëse me katër nivele të performancës:
 - **Niveli 4.** Shumë mirë
 - **Niveli 3.** Mirë, por ka nevojë për përmirësim
 - **Niveli 2.** Mjaftueshëm dhe ka nevoja të konsiderueshme për përmirësim
 - **Niveli 1.** Dobët dhe ka nevojë të domosdoshme për përmirësim

Çdo nivel përshkruhet specifikisht për kriteret që priten në atë nivel. Në vlerësimin e performancës është e rëndësishme të dëshmohet çdo vlerësim me shënime, prova, shembuj, komente, reflektime etj., që sigurojnë vlerësimin përkatës.

- ✓ Modeli i vlerësimit të performancës së mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë jepet në shtojcën nr. 8.
- ✓ Kriteret e vlerësimit të performancës sipas niveleve jepen në shtojcën nr. 9.

Në fund të vitit shkollor, drejtori i shkollës vlerëson performancën e mësuesit koordinator, bazuar në kriteret e vlerësimit, të miratuara nga ASCAP.

Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë planifikon dhe realizon veprimtarinë e tij për një periudhë 3-vjeçare. **Në fund të periudhës 3-vjeçare ZVAP-të bëjnë vlerësimin e performancës së tij**, në bazë të të cilit përcaktohet vijimi i punës në rolin e koordinatorit apo rikthimi në pozicionin e mësuesit brenda ZVAP-së. DRAP, në varësi të numrit të koordinatorëve, krijon

komision/e për vlerësimin e performancës së koordinatorit. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë: një nga DRAP (kryetar) dhe nga një anëtar nga ASCAP dhe nga AKAP.

XII. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE

Mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë veprojnë me mbështetjen e të gjitha autoriteteve arsimore, duke shërbyer si urë lidhëse midis politikave kombëtare, zbatimit lokal dhe praktikave në nivel institucioni arsimor. Ata punojnë ngushtë me drejtorin e institucionit arsimor për zhvillimin profesional të mësuesve dhe për përmirësimin e cilësisë dhe të arritjeve të nxënësve, bashkëpunojnë me autoritetet rajonale dhe lokale arsimore për burime dhe mbështetje, angazhohen me institucionet përgjegjëse të zhvillimit profesional për edukim të vazhdueshëm, si dhe respektojnë kriteret e përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Komunikimi dhe bashkëpunimi efektiv midis të gjitha këtyre subjekteve është thelbësor për krijimin e një sistemi, koherent dhe me ndikim, të përmirësimit të cilësisë, e cila prevalon në përmirësimin e arritjeve të nxënësve.

Niveli	Institucionet	Role dhe përgjegjësi
Kombëtar	MAS	<ul style="list-style-type: none"> - Harton dhe përditëson politikat kombëtare për mësuesin koordinator të sigurimit të cilësisë. - Përcakton kriteret dhe koordinon përzgjedhjen e mësuesve koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Ofron fonde dhe burime për iniciativat e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Organizon programe trajnimi në nivel kombëtar për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Koordinon monitorimin e mësuesve koordinatorë të sigurimit të cilësisë për efektivitetin e tyre.
Kombëtar	ASCAP	<ul style="list-style-type: none"> - Harton udhëzues dhe materiale mbështetëse për rolin dhe përgjegjësitë e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Vendosi kriteret kombëtare për vlerësimin e performancës së mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.

		<ul style="list-style-type: none"> - Realizon seanca informuese dhe aktivitete të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve koordinatorë të sigurimit të cilësisë, lidhur me zbatimin e përgjegjësive të tyre. - Kryen hulumtime dhe kërkime mbi praktikat më të mira për efektivitetin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Lehtëson rrjetet profesionale për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Ofron këshilla dhe mbështetje të ekspertëve për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Zhvillon dhe piloton qasje të reja për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Ofron mundësi zhvillimi të vazhdueshëm profesional për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Monitoron dhe vlerëson zbatimin e planit të aktiviteteve për zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe për sigurimin e cilësisë, të realizuar nga mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë.
<p>Kombëtar</p>	<p>AKAP</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Zbaton udhëzimet dhe materialet mbështetëse të MAS-it dhe të ASCAP-it për funksionimin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Kryen vlerësime të jashtme të institucioneve arsimore, duke përfshirë efektivitetin e rolit të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Siguron që institucionet arsimore u përmbahen udhëzimeve për përgjegjësitë e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Ofron komente të detajuara për institucionet dhe mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë për fushat për përmirësim. - Ndan praktikat më të mira nëpër IA, për efektivitetin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.

		<ul style="list-style-type: none"> - Siguron infrastrukturën e domosdoshme didaktike dhe teknologjike për efektivitetin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Monitoron punën e DRAP-eve, ZVAP-ve dhe të institucioneve arsimore në lidhje me efektivitetin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Përgatit raporte monitorimi dhe i dërgon në MAS dhe në ASCAP.
Rajonal	DRAP	<ul style="list-style-type: none"> - Përshtat politikat kombëtare për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë me kontekstet rajonale. - Zbaton udhëzimet dhe materialet mbështetëse të MAS-it, ASCAP-it, AKAP për funksionimin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Zbaton kriteret e përzgjedhjes së mësuesve koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Ofron mundësi për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë për aktivitete të zhvillimit profesional në nivel rajonal. - Organizon sesione trajnimi dhe seminare rajonale për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Lehtëson bashkëpunimin ndërmjet ZVAP-ve për iniciativat të ndryshme lidhur me mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Grumbullon dhe analizon të dhënat rajonale për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Identifikon dhe ndan praktikat më të mira nëpër IA, për efektivitetin e mësuesve koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Siguron infrastrukturën e domosdoshme didaktike dhe teknologjike për efektivitetin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë - Monitoron punën e ZVAP-ve dhe të institucioneve arsimore në lidhje me efektivitetin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Përgatit raporte monitorimi dhe i dërgon në AKAP.

<p style="text-align: center;">Lokal</p>	<p style="text-align: center;">Njësi Arsimore Vendore</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Zbaton udhëzimet dhe materialet mbështetëse të MAS-it, ASCAP-it, AKAP-it dhe DRAP-it, për funksionimin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Zbaton kriteret e përzgjedhjes së mësuesve koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Ofron mundësi për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë për aktivitete të zhvillimit profesional në nivel lokal. - Organizon rrjetet profesionale për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Ofron mbështetje të drejtpërdrejtë për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë në institucionet arsimore. - Lehtëson bashkëpunimin ndërmjet institucioneve arsimore për iniciativat të ndryshme, lidhur me mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Grumbullon të dhënat lokale për mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë. - Identifikon dhe ndan praktikat më të mira nëpër institucione arsimore për efektivitetin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Identifikon institucionet arsimore që mund të kenë nevojë për mbështetje shtesë në funksionimin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë dhe i këshillon ato. - Siguron infrastrukturën e domosdoshme didaktike dhe teknologjike për efektivitetin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Monitoron punën e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë. - Përgatit raporte monitorimi dhe i dërgon në DRAP.
<p style="text-align: center;">Shkolla</p>	<p style="text-align: center;">Drejtuesi i shkollës</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ofron udhëheqje dhe mbështetje për mësuesin koordinator të sigurimit të cilësisë.



- Zbaton udhëzimet dhe materialet mbështetëse të MAS-it, ASCAP-it, AKAP-it, DRAP-it dhe ZVAP-së, për funksionimin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.
- Ofron mbështetje të drejtpërdrejtë për mësuesin koordinator të sigurimit të cilësisë në nivel shkolle.
- I siguron të gjitha materialet e nevojshme të IA-së për realizimin e veprimtarisë së mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.
- Mbështet zhvillimin profesional të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.
- Lehtëson bashkëpunimin ndërmjet mësuesve për realizimin e përgjegjësive të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.
- Identifikon dhe ndan praktikat më të mira mbi efektivitetin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.
- Siguron infrastrukturën e domosdoshme didaktike dhe teknologjike për efektivitetin e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.
- Monitoron zhvillimin e punës së mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë, si dhe zbatimin e planit vjetor të tij.
- Vlerëson performancën e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë dhe gjykon për vijimin e punës së tij për vitin pasardhës.
- Nxit një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm brenda IA-së.

Shënim. Drejtori dhe nëndrejtori i shkollës, drejtuesi i ekipit kurrikular, mësuesi mentor, koordinatori i këshillimit për karrierë, drejtuesi i rrjetit profesional, nuk zëvendësohen në asnjë prej përgjegjësive që ka koordinatori i sigurimit të cilësisë.

XIII. SHTOJCAT

13.1 Shtojca 1: Shembuj të formulimit objektivave dhe një model kalendari për planin vjetor të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë

a) Shembuj të formulimit të objektivave vjetore të detajuara të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë

Shembuj të formulimeve të objektivave	Matja e realizimit të tyre
Deri në fund të vitit shkollor, të paktën 90% e mësuesve (27 nga 30 mësues) marrin pjesë në aktivitete të zhvillimit profesional për përdorimin e metodave të mësimdhënies që nxisin mendimin krijues te nxënësit.	Pjesëmarrja në aktivitetet e zhvillimit profesional matet me dëshmitë përkatëse të këtyre aktiviteteve.
Deri në fund të vitit shkollor, të paktën 80% e mësuesve (24 nga 30 mësues) zhvillojnë në procesin mësimor metoda të mësimdhënies që nxisin mendimin krijues.	Zbatimi i metodave që nxisin krijues mund të matet përmes vëzhgimeve të orëve mësimore dhe anketave me nxënësit.
Deri në fund të vitit shkollor, 80% e mësuesve (24 nga 30 mësues) demonstrojnë përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor.	Përdorimi i teknologjisë në procesin mësimor matet me orë mësimore të vëzhguara dhe materiale të hartuara përmes TIK-ut.
Deri në fund të vitit shkollor, të rritet performanca e nxënësve me arritje të ulëta në lëndët kryesore me 20%.	Ky objektiv mund të matet me anë të analizës së rezultateve të testeve dhe krahasimit të përparimit të nxënësve nga periudha në periudhë, rezultateve në fund të vitit shkollor, veprimtarive plotësuese ose përforcuese.
Deri në fund të vitit shkollor, përqindja e nxënësve që marrin pjesë në mënyrë aktive në orë mësimore (p.sh., në diskutime, detyra në grup) rritet me 25%, duke përdorur teknika efektive të angazhimit aktiv në klasë.	Ky objektiv mund të matet me anë të vëzhgimeve në orë mësimore dhe analizave krahasuese të pjesëmarrjes dhe të përfshirjes aktive të nxënësve në orën e mësimi.
Deri në fund të vitit shkollor të paktën 70% e nxënësve marrin pjesë në orët e konsultimeve për provimet kombëtare.	Ky objektiv mund të matet me vëzhgime dhe analiza krahasuese.

b) Modeli i kalendarit të planit vjetor

VITI 2024														
Dimensioni 1: Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve														
Veprimtaritë	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Metoda/t	Realizimi i Veprimtarisë
1.1 Vlerësimi dhe identifikimi i nevojave të mësuesve													Realizimi i intervistave me mësuesit	U realizuan intervistat me 30 mësues të shkollës.
....														
1.6 Takim (bashkëbisedim) me ekipet lëndore për metodat efektive në mësimdhënie													Bashkëbisedim për zbatimin e metodave dhe të teknikave, të dhëna në trajnimet e realizuara nga IAL-të	U realizua takimi me 3 ekipet lëndore të shkollës.
1.9 Vëzhgime në orë mësimore													Orë të plota ose pjesëmarrje e pjeshme sipas planit mujor.	U realizuan ... vëzhgime në orë të plota dhe ... vëzhgime të pjeshme me

														tematikë të përcaktuar.
.....														
Dimensioni 2: Sigurimi i cilësisë dhe përmirësimi i arritjeve të nxënësve														
Veprimtaritë	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Metoda	Realizimi i veprimtarisë
2.5 Mbledhja e të dhënave të periudhës së parë për nxënësit me arritje të ulëta dhe analiza e tyre në lëndët: Gjuhë shqipe dhe Matematikë													Përpunimi i notave të periudhës së parë, në klasat 6-9, për nxënësit me arritje të ulëta për gjuhën shqipe dhe për matematikën	U realizua analiza e rezultateve të periudhës së parë, me 8 klasa dhe me 170 nxënës.
.....														

Dimensioni 3: Planifikimi dhe zhvillimi i kurrikulës

Veprimtaritë	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Metoda	Realizimi i veprimtarisë
<i>Takim (sesion) me ekipet lëndore për udhëzuesit e ASCAP-it në zbatim të platformave interaktive</i>													<i>Grup i ekspertëve. Mësuesi i TIK-ut dhe mësuesi i fizikës prezantojnë përdorimin e platformave në PTHET Simulation dhe organizojnë zbatimin me mësuesit e tjerë.</i>	<i>U realizua me 15 mësues të shkencave të natyrës dhe të matematikës.</i>
.....														

13.2 Shtojca 2: Formati i instrumentit për vlerësimin e orës mësimore

Nr.	Treguesit e cilësisë	PËRSHKRUESIT	Pikët në total për secilin përshkrues	Nivelet e vlerësimit				Pikët e fituara
				1	2	3	4	
1	<i>Planifikimi i orës mësimore të hapur (6 pikë)</i>	Mësuesi ka planifikuar të gjitha komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënës.	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënës gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave lëndore.	3 pikë	0	1	2	3	
2	<i>Mjedisi i të nxënës</i> (6 pikë)	Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri -tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndër marrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	3 pikë	0	1	2	3	
3	<i>Metodat mësimore (6 pikë)</i>	Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik dhe krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe mendimin ndryshe.	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe të llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimin.	3 pikë	0	1	2	3	
4	<i>Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (6 pikë)</i>	Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënës së tij duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes.	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënës dhe nevojave të tyre.	3 pikë	0	1	2	3	
5	<i>Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (6 pikë)</i>	Mësuesi përdor mjete mësimore didaktike për të konkretizuar informacionet e temës mësimore, si dhe për të lehtësuar të nxënës e nxënësve	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.	3 pikë	0	1	2	3	
Vlerësimi i përgjithshëm			30 pikë gjithsej	Pikët e fituara nga mësuesi				

Mësuesi: _____

Mësuesi koordinator i cilësisë: _____

13.3 Shtojca 3: Formati i instrumentit për vlerësimin e projektit kurrikular

Nr.	Treguesit e cilësisë	PËRSHKRUESIT	Pikët në total për secilin përshkrues	Nivelet e vlerësimit				Pikët e fituara
				1	2	3	4	
1	<i>Aftësitë kërkimore/hulumtuese. Demonstrimi i tyre (12 pikë)</i>	Demonstrimi i aftësive hulumtuese, kërkimore, krijuese.	3 pikë	0	1	2	3	
		Bashkëpunimi në grup. Grupi orientohet dhe drejtohet vetë.	3 pikë	0	1	2	3	
		Përqendrimi te detyra e dhënë.	3 pikë	0	1	2	3	
		Përdorimi i informacioneve të përshtatshme për detyrën.	3 pikë	0	1	2	3	
2	<i>Analiza dhe interpretimi i të dhënave, fakteve, ngjarjeve etj. Zgjedh dhe zbaton teknika të përshtatshme (10 pikë)</i>	Përdorimi gjatë gjithë projektit i teknikave të përshtatshme, efektive, krijuese dhe origjinale.	3 pikë	0	1	2	3	
		Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk kanë gabime shkencore.	3 pikë	0	1	2	3	
		Përdorimi i TIK-ut përgjatë fazave të ndryshme të projektit dhe përdorimi i skemave, diagrameve etj.	4 pikë	0-1	2	3	4	
3	<i>Aftësitë e prezantimit. Prezantimi në mënyrë efektive i rezultateve të projektit (18 pikë)</i>	Krijimi dhe organizimi i materialit krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe kuptimi.	6 pikë	0-1	2-3	4-5	6	
		Rezultatet e projektit janë origjinale dhe prezantohen qartë.	6 pikë	0-1	2-3	4-5	6	
		Vlerësimi ndikon pozitivisht në progresin e nxënësit.	6 pikë	0-1	2-3	4-5	6	
		Vlerësimi i përgjithshëm	40 pikë gjithsej					

Mësuesi: _____

Mësuesi koordinator i cilësisë: _____

13.4 Shtojca 4: Kriteret e vlerësimit të orës mësimore

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore:

- mbështesin mësuesit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë, si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore për të gjykuar dhe për të vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore.

Zhvillimi i orës mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet dhe sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore				
Gjithsej 30 pikë				
Përshkruesit	Niveli 1 - Dobët	Niveli 2 –Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
Planifikimi i orës mësimore të hapur (6 pikë)				
	0 pikë	1 pikë	2 pikë	3 pikë
Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimit në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënës.	<i>Nuk ka një koherencë mes komponentëve të orës mësimore. Rezultatet e të nxënës (RN) nuk bazohen në programin lëndor Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënës. Pyetjet që janë</i>	<i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënës, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxënës (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxënës. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur</i>	<i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënës, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodot dhe teknikat mësimore janë në koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënës dhe me stilet e të nxënës. Mësuesi ka</i>	<i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënës, të cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me</i>

	<i>planifikuar nuk janë të llojeve dhe të niveleve të ndryshme.</i>	<i>me stilet e të nxënit. Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.</i>	<i>planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i>	<i>stilet e të nxënit, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i>
Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, përveç kompetencave lëndore.	<i>Mësuesi nuk planifikon duke përfshirë qasje të reja inovative dhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>
Mjedisi i të nxënit (6 pikë)				
Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri -	<i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, por jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimit vetëm disa nxënës përfshihen në veprimtaritë e orës së</i>	<i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, por jo të gjithë ndihen të</i>	<i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi</i>

tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	<i>mësimin për të shprehur mendimet e tyre.</i>		<i>suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>ka krijuar një kulturë të nxëni për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i>
Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	<i>Mësuesi organizon orën e mësimin në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimin.</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimin në mënyrë tradicionale, ku jo të gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimin duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi pasivë. Ai u kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>Mësuesi organizon orën e mësimin duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
Metodat mësimore (6 pikë)				
Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, dhe krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin), si dhe mendimin ndryshe.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimin duke u përqendruar më së shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, ai përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik dhe krijues të nxënësit, që nxisin</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimin, duke u përqendruar më së shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxitin mendimin kritik dhe krijues të nxënësit, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshmërinë e metodave të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, ai përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik dhe krijues të nxënësit, që nxisin</i>

	<i>të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>	<i>demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i>		<i>diskutimin (apo debatin) dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i>
Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje..</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk u jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit, por nuk u jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.</i>
Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (6 pikë)				
Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve	<i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimit. Mësuesi përdor disa teknika vlerësimi, por nuk përdor nivelet e arritjes për të vlerësuar përmbushjen e rezultateve të nxënësve të orës mësimore.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit. Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e nxënësve të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit, duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin për të identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.</i>

nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes.			<i>vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënit të orës mësimore.</i>
Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënit dhe nevojave të nxënësve.	<i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënit apo nevojat e nxënësve.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, por angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara, duke u bazuar në nevojat e tyre.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënit dhe nevojave të tyre.</i>
Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (6 pikë)				
Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	<i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore, por nuk i angazhon shumë nxënës në përdorimin e tyre.</i>	<i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxisë te ata të mësuarin praktik dhe krijues.</i>

<p>Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</p>	<p><i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore,</i></p>	<p><i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale, por ato nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënit të temës mësimore.</i></p>	<p><i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore, por nxënësit nuk angazhohen në përdorimin e TIK-ut.</i></p>	<p><i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i></p>
---	---	---	--	---

13.5 Shtojca 5: Kriteret e vlerësimit të projektit kurrikular

Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular vjetor				
Gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 – Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
Aftësitë kërkimore/ hulumtuese. Demonstrimi i tyre (12 pikë)	0-2 pikë Nxënësit rrallëherë përqendrohen te detyra e tyre. Ata mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme. Nxënësit përdorin një burim për të gjetur informacione.	3-6 pikë Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk përqendrohen vetëm te detyra e tyre. Ata mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë. Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	7-9 pikë Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre shumicën e kohës. Ara mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde. Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	10-12 pikë Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre. Ata orientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. Nxënësit mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe komentojnë për të zgjidhur probleme. Nxënësit përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
Analiza dhe interpretimi i të dhënave, fakteve, ngjarjeve etj. Zgjedhja dhe zbatimi i teknikave të përshtatshme (10 pikë)	0-2 pikë Nxënësit rrallëherë përdorin teknika të përshtatshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban shumë gabime.	3-5 pikë Nxënësit ndonjëherë përdorin teknika të përshtatshme, por jo në mënyrë të vazhdueshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban disa gabime të rëndësishme.	6-8 pikë Nxënësit zakonisht përdorin teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban pak gabime.	9-10 pikë Nxënësit përdorin gjatë gjithë projektit teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk përmban gabime.

<p>Aftësitë e prezantimit: Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit (18 pikë)</p>	<p>0-5 pikë</p> <p>Në prezantimin e nxënësve material i është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri -tjetrin. Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.</p>	<p>6-9 pikë</p> <p>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë mirë punën e tyre. Prezantimi jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari. Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.</p>	<p>10-14 pikë</p> <p>Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari. Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.</p>	<p>15-18 pikë</p> <p>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë shumë mirë punën e tyre që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari. Rezultatet e projektit prezantohen qartë.</p>
---	---	--	---	---

13.6 Shtojca 6: Model relacioni për një aktivitet të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në nivel shkolle

Relacion për aktivitetin e ZHVP-së në nivel IA-je

Data e aktivitetit	Tema e aktivitetit	Nr. i mësuesve pjesëmarrës

Çështje të diskutuara në takim

Materiale burimore të përdorura për takimin	Sugjerime dhe rekomandime

Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë _____ . Firma _____

13.7 Shtojca 7: Model pyetësori për efektivitetin e aktivitetit të ZHVP-së

Lloji i aktivitetit të ZHVP-së: _____

Ju falënderojmë shumë për pjesëmarrjen tuaj në këtë aktivitet të zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përshtypjet tuaja kanë rëndësi për përmirësimin e aktiviteteve në vijim.

Shënim. Ky pyetësor mund të zhvillohet në Google Forms.

Nr.	Pohimi	Nuk e di	Aspak dakord	Pjesërisht dakord	Plotësisht dakord
1.	Aktiviteti i ZHVP-së përmbushi pritshmëritë tuaja profesionale.				
2.	Niveli i aktivitetit ishte cilësor.				
3.	Aktiviteti i ZHVP-së është i rëndësishëm për punën tuaj.				
4.	Kohëzgjatja e aktivitetit ishte e përshtatshme.				
5.	Njohuritë dhe aftësitë që fituat në këtë aktivitet, mund t'i përdorni në punën tuaj.				
6.	Aktivitetin mund t'ua rekomandoni kolegëve tuaj, si i vlefshëm edhe për ata.				
7.	Mjedisi ku u zhvillua aktiviteti, ishte i përshtatshëm.				
8.	Përmbajtja teorike e aktivitetit ishte cilësore.				
9.	Veprimtaritë/ seancat praktike ishin ndërvepruese dhe cilësore.				
10.	Njohuritë dhe aftësitë e drejtuesit të aktivitetit (ose trajnuesit) ishte në nivelin e duhur.				
11.	Aktiviteti në përgjithësi ishte cilësor.				

A keni ndonjë koment tjetër:

13.8 Shtojca 8: Formati i vlerësimit të performancës së mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë

PJESA 1: TË DHËNA PERSONALE

Emri/mbiemri: _____

Institucioni arsimor: _____

ZVAP : _____

Data e vlerësimit: _____

Drejtori i institucionit arsimor: _____

PJESA 2: KONTEKSTI I PUNËS

Objektivat e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë (_____) për vitin shkollor janë:

(Objektivat duhet të shkruhen në mënyrë të tillë që të jenë: specifikë, të matshëm, të arritshëm, realistë)

1. _____

2. _____

PJESA 3: OBJEKTIVAT DHE VLERËSIMI I PERFORMANCËS PËR REALIZIMIN E TYRE

Objektivi 1: _____

Niveli 4. Shumë mirë, kur objektivi është arritur në masën 90-100%	Niveli 3. Mirë, kur objektivi është arritur në masën 70-89 %	Niveli 2. Mjaftueshëm, kur objektivi është arritur në masën 50% – 69%	Niveli 1. Dobët, kur objektivi është arritur në masën më pak se 50%
Vlerësimi: _____			
Komentet e drejtorit të IA-së/ Shpjegime:			

Objektivi 2: _____

Niveli 4. Shumë mirë, kur objektivi është arritur në masën 90-100%	Niveli 3. Mirë, kur objektivi është arritur në masën 70-89 %	Niveli 2. Mjaftueshëm, kur objektivi është arritur në masën 50% – 69%	Niveli 1. Dobët, kur objektivi është arritur në masën më pak se 50%
Vlerësimi: _____			
Komentet e drejtorit të IA-së/ Shpjegime: _____			

PJESA 4: VLERËSIMI PËR PËRMBUSHJEN E PËRGJEGJËSIVE PROFESIONALE

Në këtë pjesë, drejtori i IA-së vlerëson përmbushjen e përgjegjësive profesionale nga mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë.

Nr	Përgjegjësitë	Niveli 4. Shumë mirë	Niveli 3. Mirë, por ka nevojë për përmirësim	Niveli 2. Mjaftueshëm dhe ka nevoja të konsiderueshme për përmirësim	Niveli 1. Dobët dhe ka nevojë të domosdoshme për përmirësim
Dimensioni 1. Përgjegjësitë e mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve					
1.	Njeh programin kombëtar të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve dhe i nxit ata të jenë pjesë e këtij programi.				
2.	Analizon rregullisht nevojat për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit mësimor, duke u bazuar në rezultatet e nxënësve, në rezultatet e kualifikimit të mësuesve, në rezultatet e provimeve kombëtare dhe të vlerësimeve ndërkombëtare etj.				
3.	I propozon drejtorit të shkollës nisma të reja për zhvillimin e brendshëm të stafit mësimor.				
4.	Harton në bashkëpunim me stafin drejtues planin e aktiviteteve për zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe të sigurimit të cilësisë				
5.	Koordinon procesin e zbatimit të planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, duke nxitur edhe shkëmbimin e përvojave të mësuesve me njëri- tjetrin.				
6.	Krijon mundësi për të gjithë mësuesit të marrin pjesë në aktivitete të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, duke siguruar numrin e nevojshëm të krediteve vjetore për çdo mësues.				
7.	Ofron udhëzime, mbështetje dhe inkurajim për mësuesit e rinj dhe veçanërisht për ata që akoma nuk kanë fituar akoma kategorinë “Mësues i kualifikuar”.				

8.	Vëzhgon mësuesit në procesin mësimor për efektivitetin e aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në procesin mësimor dhe i inkurajon ata të përdorin aftësitë e fituara gjatë veprimtarive të ZHVP-së				
9.	Mbështet mësuesin kandidat për procesin e kualifikimit në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e orës mësimore të hapur dhe/ose orës së projektit kurrikular.				
10.	Merr pjesë dhe vlerëson orën mësimore të hapur dhe/ose orën e projektit kurrikular, të realizuar nga mësuesi kandidat për procesin e kualifikimit.				
11.	Mbështet stafin drejtues në aplikimin dhe në menaxhimin e projekteve që mund të ketë shkolla.				

Dimension 2. Përgjegjësitë e mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e arritjeve të nxënësve

12.	Mbështet dhe monitoron punën e mësuesve për të gjitha llojet dhe mënyrat e vlerësimit të nxënësve.				
13.	Mbështet stafin drejtues në analizën rezultateve të nxënësve sipas periudhave mësimore dhe vjetore për të mbështetur dhe për të nxitur përparimin e tyre.				
14.	Mbështet dhe ndjek zbatimin e planeve për përmirësimin e rezultateve të nxënësve, përgatitjen e tyre për provimet kombëtare, vlerësimet ndërkombëtare, olimpiadat, konkurset etj.				
15.	Mbështet stafin drejtues për analizën e rezultateve të nxënësve në provime kombëtare, vlerësime ndërkombëtare, olimpiada, konkurse etj.				
16.	Bën rekomandime në drejtorinë e shkollës që nxënësit të marrin mbështetje të mjaftueshme për provimet kombëtare, vlerësimet ndërkombëtare, olimpiadat, konkurset etj., siç janë këshillimi, orë mësimore shtesë, konsultime, testime përgatitore etj.				
17.	Mbështet stafin drejtues për zhvillimin e procesit të vetëvlerësimit të shkollës.				

Dimensioni 3. Përgjegjësitë e mësuesit koordinator për planifikimin dhe për zhvillimin e kurrikulës në institucionin arsimor

18.	Koordinon punën në bashkëpunim me kryetarët e ekipeve lëndore për hartimin e planeve lëndore.				
19.	Udhëzon mësuesit, në bashkëpunim me kryetarët e ekipeve lëndore, për përdorimin e materialeve mësimore dhe metodologjive bashkëkohore (përfshirë qasjen STEM dhe përdorimin e TIK-ut), kriteret e hartimit të testeve, planifikimin dhe zhvillimin e projekteve lëndore dhe ndërlëndore, analizën e arritjeve të nxënësve etj.				
20.	Harton një kalendar në bashkëpunim me mësuesit për vëzhgimin e orëve mësimore të mësuesit, me qëllim identifikimin e nevojave për zhvillim profesional, mbështetjen dhe promovimin e praktikave pozitive në shkollë.				
21.	Vëzhgon orë mësimore të mësuesit dhe ofron rekomandime për përmirësimin e cilësisë së tyre.				
22.	Mbështet zbatimin e risive kurrikulare në shkollë dhe propozon me shkrim përmirësime të kurrikulës dhe të teksteve shkollore, të cilat i dorëzon në përfundim të vitit shkollor në drejtorinë e shkollës.				
23.	Koordinon punën për planifikimin dhe zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle.				
24.	Propozon ide inovatore në organizimin e aktiviteteve shkollore, me synimin për t'iu përgjigjur nevojave të nxënësve dhe pritshmërive të prindërve dhe të komunitetit.				
TOTAL i pikëve					
Niveli i performancës për përmbushjen e përgjegjësisve profesionale					

VLERËSIMI:

Niveli 1: (Dobët dhe ka nevojë të domosdoshme për përmirësim). Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë nuk ka përmbushur pritshmëritë lidhur me përgjegjësitë profesionale (0 – 40 pikë).

Niveli 2: (Mjaftueshëm dhe ka nevoja të konsiderueshme për përmirësim). Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë ka treguar përmbushje në nivel të mjaftueshëm të përgjegjësive profesionale (41-60 pikë).

Niveli 3: (Mirë, por ka nevojë për përmirësim). Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë ka treguar përmbushje të nivelit mirë të përgjegjësive profesionale (61 – 80 pikë).

Niveli 4: (Shumë mirë). Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë ka treguar përmbushje shumë të mirë të përgjegjësive profesionale, të cilat e dallojnë nga të tjerët (81 – 96 pikë).

Drejtori i shkollës: _____

Firma:

Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë: _____

Firma:

Data: _____

13.9 Shtojca 9: Kriteret e vlerësimit të përgjegjësive profesionale të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë

DIMENSIONI I. ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL I MËSUESVE			
Niveli i performancës “Dobët” (Ka nevoja të domosdoshme për përmirësim.)	Niveli i performancës “Mjaftueshëm” (Ka nevoja të konsiderueshme për përmirësim.)	Niveli i performancës “Mirë”, (Ka nevojë për përmirësim.)	Niveli i performancës “Shumë mirë”
1.1 Njeh programin kombëtar të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve dhe i nxit ata të jenë pjesë e këtij programi.			
Nuk e njeh programin kombëtar dhe nuk inkurajon pjesëmarrjen e mësuesve.	Ka njohuri bazë për programin kombëtar dhe herë pas here ua përmend mësuesve.	Promovon në mënyrë aktive programin kombëtar dhe inkurajon rregullisht mësuesit të marrin pjesë.	Kupton plotësisht programin kombëtar, e promovon vazhdimisht atë dhe krijon strategji për të maksimizuar pjesëmarrjen e mësuesve.
1.2 Analizon rregullisht nevojat për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit mësimor, duke u bazuar në rezultatet e nxënësve, në rezultatet e kualifikimit të mësuesve, në rezultatet e provimeve kombëtare, të vlerësimeve ndërkombëtare etj.			
Pak ose aspak dëshmi për kryerjen e vlerësimeve të nevojave ose përdorimin e të dhënave për të planifikuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve.	Kryen vlerësime të nevojave bazë, por nuk përdor vazhdimisht të dhëna për të përditësuar dhe përmirësuar planifikimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve.	Kryen rregullisht vlerësime gjithëpërfshirëse të nevojave dhe përdor të dhënat në mënyrë efektive për të planifikuar zhvillimin përkatës profesional.	Zbaton qasje inovative për vlerësimin e nevojave, duke përfshirë aktorë të shumtë dhe burime të dhënash të shumëllojshme për të krijuar plane zhvillimi profesional të dedikuara dhe individuale.
1.3 I propozon drejtorit të shkollës nisma të reja për zhvillimin e brendshëm të stafit mësimor.			
Rrallë ose kurrë nuk propozon iniciativa të reja.	Herë pas here propozon iniciativa bazë, kryesisht duke përsëritur programet ekzistuese.	Propozon rregullisht iniciativa të mirëmenduara, bazuar në nevojat e stafit.	Propozon vazhdimisht iniciativa novatore, të bazuara në kërkime, të përshtatura për kontekstet specifike të shkollës dhe për nevojat individuale të mësuesve.
1.4 Harton në bashkëpunim me stafin drejtues planin e veprimtarive për zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe të sigurimit të cilësisë.			

Përfshihet minimalisht në planifikim ose nuk përfshihet fare.	Merr pjesë në planifikim, por me kontribut ose bashkëpunim të kufizuar.	Bashkëpunon në mënyrë aktive në krijimin e një plani gjithëpërfshirës	Merr një rol udhëheqës në zhvillimin e një plani të detajuar, duke siguruar bashkëpunim të plotë me stafin drejtues.
1.5 Koordinon procesin e zbatimit të planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, duke nxitur shkëmbimin e përvojave të mësuesve me njëri-tjetrin.			
Koordinim minimal i zbatimit të planit.. Pak ose aspak inkurajim i shkëmbimit të mësuesve.	Koordinim bazë i zbatimit të planit. Herë pas here nxit shkëmbimin e mësuesve.	Koordinon në mënyrë efektive zbatimin e planit. Rregullisht lehtëson mundësitë e shkëmbimit të mësuesve.	Koordinon me ekspertizë zbatimin e planit, si dhe krijon platforma inovative për shkëmbimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm të mësuesve.
1.6 Krijon mundësi për të gjithë mësuesit të marrin pjesë në aktivitete të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, duke siguruar numrin e nevojshëm të krediteve në vit për çdo mësues.			
Pak mundësi të krijuara, pak vëmendje ndaj kërkesave për kredite.	Mundësi bazë të ofruara. Plotëson kërkesat minimale të krediteve për shumicën e mësuesve.	Krijon mundësi të ndryshme. Siguron që të gjithë mësuesit të përmbushin kërkesat për kredite.	Krijon mundësi të shumta, të larmishme. I ndihmon mësuesit të tejkalojnë kërkesat e krediteve përmes planeve të personalizuara të zhvillimit.
1.7 Ofron orientim, mbështetje dhe inkurajim për mësuesit e rinj dhe veçanërisht për ata që nuk e kanë fituar ende kategorinë "Mësues i kualifikuar".			
Udhëzime ose mbështetje minimale të ofruar për mësuesit e rinj ose të pakualifikuar.	Mbështetja bazë, e ofruar sipas kërkesës së mësuesve.	Ofron në mënyrë proaktive udhëzime dhe mbështetje përmes vëzhgimeve të rregullta dhe mentorimit.	Zbaton një sistem gjithëpërfshirës të mbështetjes duke përfshirë mentorimin e personalizuar, burimet dhe planet e zhvillimit.
1.8 Vëzhgon mësuesit në procesin mësimor për efektivitetin e aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në procesin mësimor dhe i inkurajon ata të përdorin aftësitë e fituara gjatë veprimtarive të ZHVP-së.			
Rrallë vëzhgon mësuesit ose jep komente.	Kryen vëzhgimet e nevojshme me reagime bazë.	Vëzhgon rregullisht mësuesit, duke ofruar reagime dhe inkurajim konstruktiv.	Zbaton një sistem të mirëmenduar vëzhgimi me reagime të detajuara, mbështetje pasuese dhe strategji për zbatimin e aftësive.
1.9 Mbështet mësuesin kandidat për procesin e kualifikimit në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e orës mësimore të hapur dhe/ose orës së projektit kurrikular.			
Mbështetje minimale ose nuk e ofron fare.	Ofron informacion bazë dhe u përgjigjet pyetjeve kur bëhen nga mësuesit.	Ofron mbështetje proaktive, duke përfshirë ndihmën në	Ofron mbështetje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë seminare, mentorime dhe

		planifikim dhe ofron reagime konstruktive.	këshillime individuale me burime të detajuara.
1.10 Merr pjesë dhe vlerëson orën mësimore të hapur dhe/ose orën e projektit kurrikular të realizuar nga mësuesi kandidat për procesin e kualifikimit.			
Rrallë merr pjesë ose jep vlerësim sipërfaqësor.	Merr pjesë dhe jep vlerësime bazë duke përdorur kritere standarde.	Merr pjesë aktive, duke ofruar vlerësim të detajuar dhe konstruktiv.	Angazhohet plotësisht në proces, duke ofruar vlerësim të detajuar, të thellë dhe me reagime vepruese për përmirësim.
1.11 Mbështet stafin drejtues në aplikimin dhe në menaxhimin e projekteve që mund të ketë shkolla.			
Përfshirje minimale në projektet e shkollës.	Ndihmon me projekte, kur kërkohet drejtpërdrejt, duke ofruar mbështetje bazë.	Mbështet në mënyrë aktive aplikimin dhe menaxhimin e projekteve, duke ofruar të dhëna të vlefshme.	Merr një rol udhëheqës në identifikimin, aplikimin dhe menaxhimin e projekteve shkollore, duke rritur ndjeshëm portofolin e projekteve të shkollës.
DIMENSIONI 2. SIGURIMI I CILËSISË DHE PËRMIRËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE			
2.1 Mbështet dhe monitoron punën e mësuesve për të gjitha llojet dhe mënyrat e vlerësimit të nxënësve.			
Ofron mbështetje minimale ose aspak për metodat e vlerësimit. Monitoron rrallë praktikat e mësuesve.	Ofron mbështetje bazë për metodat e zakonshme të vlerësimit. Herë pas here monitoron praktikat e mësuesve.	Mbështet dhe monitoron rregullisht metoda të ndryshme vlerësimi. Ofron reagime konstruktive për mësuesit.	Mbështet në mënyrë proaktive metoda novatore të vlerësimit. Implementon një sistem gjithëpërfshirës të monitorimit. Ofron udhëzime të përshtatura për të përmirësuar praktikat e vlerësimit të nxënësit.
2.2 Mbështet stafin drejtues në analizën rezultateve të nxënësve sipas periudhave mësimore dhe vjetore për të mbështetur dhe nxitur përparimin e tyre.			
Rrallë përfshihet në analizën e rezultateve. Ofron pak ose aspak mbështetje për stafin drejtues.	Merr pjesë në analizën bazë të rezultateve kur i kërkohet. Ofron sugjerime të kufizuara për përmirësim.	Mbështet në mënyrë aktive analizën e rezultateve. Ofron rregullisht rekomandime për përparimin e nxënësve.	Merr një rol udhëheqës në analizën gjithëpërfshirëse të rezultateve. Zhvillon strategji të drejtuara nga të dhënat për përmirësim të vazhdueshëm. Komunikon në mënyrë efektive gjetjet për të gjitha palët e interesuara.
2.3 Mbështet dhe ndjek zbatimin e planeve për përmirësimin e rezultateve të nxënësve, përgatitjen e tyre për provimet kombëtare, vlerësimet ndërkombëtare, olimpiadat, konkurset etj.			

Përfshirje minimale në planet e përmirësimit ose përgatitjen e provimeve.	Ofron mbështetje bazë për planet ekzistuese të përmirësimit dhe për përgatitjen e provimeve.	Mbështet dhe monitoron në mënyrë aktive zbatimin e planeve të përmirësimit gjithëpërfshirës. Ndjek rregullisht përgatitjen e provimeve.	Harton dhe zbaton strategji novatore për përmirësimin e rezultateve dhe përgatitjen e provimeve. Vazhdimisht vlerëson dhe përditëson planet në bazë të rezultateve të nxënësve.
---	--	---	---

2.4 Mbështet stafin drejtues për analizën e rezultateve të nxënësve në provime kombëtare, vlerësime ndërkombëtare, olimpiada, konkurse etj.

Ofron pak ose aspak mbështetje në analizimin e rezultateve të vlerësimeve të jashtme.	Ofron ndihmë bazë në përpilimin dhe paraqitjen e të dhënave të vlerësimeve të jashtme.	Mbështet në mënyrë aktive analizën e thelluar të rezultateve të vlerësimeve të jashtme; ndihmon në identifikimin e tendencave dhe fushave për përmirësim.	Drejton analiza gjithëpërfshirëse të të gjitha vlerësimeve të jashtme; propozon strategji të synuara për të përmirësuar performancën e nxënësve në të gjitha fushat.
---	--	---	--

2.5 Bën rekomandime në drejtorinë e shkollës që nxënësit të marrin mbështetje të mjaftueshme për provimet kombëtare, vlerësime ndërkombëtare, olimpiadat, konkurset etj., siç janë këshillimi, orë mësimore shtesë, konsultime, testime përgatitore etj.

Rrallë bën rekomandime; sugjerimet janë të paqarta ose të padobishme.	Herë pas here bën rekomandime bazë për mbështetjen e nxënësve.	Ofron rregullisht rekomandime të mirëmenduara për mbështetjen gjithëpërfshirëse të nxënësve.	Ofron vazhdimisht rekomandime novatore, të bazuara në dëshmi, rezultate; zhvillon strategji të përshtatura mbështetëse për grupe të ndryshme nxënësish.
---	--	--	---

2.6 Mbështet stafin drejtues për zhvillimin e procesit të vetëvlerësimit të shkollës.

Përfshirje minimale në procesin e vetëvlerësimit të shkollës.	Ofron ndihmë bazë kur i kërkohet nga stafi drejtues në procesin e vetëvlerësimit.	Mbështet në mënyrë aktive zhvillimin dhe zbatimin e një procesi gjithëpërfshirës të vetëvlerësimit.	Merr një rol udhëheqës në hartimin dhe zbatimin e një sistemi inovativ, të vazhdueshëm të vetëvlerësimit; siguron angazhim të plotë të palëve të interesuara dhe përdor rezultatet e nxënësve për të nxitur përmirësimin e shkollës.
---	---	---	--

DIMENSIONI 3. PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI I KURRIKULËS

3.1 Koordinon punën në bashkëpunim me kryetarët e ekipeve lëndore për hartimin e planeve lëndore.

Koordinim minimal; pak ose aspak bashkëpunim me kryetarët e ekipeve lëndore.	Koordinimi bazë; takime të herëpashershme me kryetarët e ekipeve lëndore.	Koordinim i rregullt; bashkëpunim aktiv me kryetarët e ekipeve lëndore në hartimin e planeve.	Koordinim proaktiv, gjithëpërfshirës; lehtëson bashkëpunimin mes ekipeve lëndore, duke siguruar plane lëndore efektive dhe me cilësi të lartë.
3.2 Udhëzon mësuesit në bashkëpunim me kryetarët e ekipeve lëndore për përdorimin e materialeve mësimore dhe metodologjive bashkëkohore (përfshirë qasjen STEM dhe përdorimin e TIK-ut), kriteret e hartimit të testeve, planifikimin dhe zhvillimin e projekteve lëndore dhe ndërlëndore, analizën e arritjeve të nxënësve etj.			
Ofron pak ose aspak udhëzime; rrallë bashkëpunon me kryetarët e ekipeve lëndore.	Ofron udhëzime bazë për metodologjitë tradicionale; bashkëpunim i kufizuar me kryetarët e ekipeve lëndore.	Udhëzon rregullisht mësuesit për metodologjitë bashkëkohore; bashkëpunon në mënyrë aktive me kryetarët e ekipeve lëndore.	Ofron udhëzime gjithëpërfshirëse dhe novatore; nxit një kulturë bashkëpunimi dhe përmirësim të vazhdueshëm në praktikatat e mësimdhënies dhe zhvillimin e projekteve kurrikulare.
3.3 Harton një kalendar në bashkëpunim me mësuesit për vëzhgimin e orëve mësimore të mësuesit, me qëllim identifikimin e nevojave për zhvillim profesional, mbështetjen dhe promovimin e praktikave pozitive në shkollë.			
Nuk ka kalendar sistematik vëzhgimi; vëzhgimet janë të rralla ose të rastësishme.	Ekziston një kalendar bazë i vëzhgimeve, por nuk është gjithëpërfshirës ose i ndjekur vazhdimisht.	Kalendar i mirëstrukturuar i vëzhgimit të orëve mësimore i zhvilluar në bashkëpunim me mësuesit; kryerje e vëzhgimeve të rregullta.	Sistemi gjithëpërfshirës, fleksibël i vëzhgimit në orët mësimore; vëzhgimet janë të shpeshta, të synuara dhe përdoren në mënyrë efektive për zhvillimin profesional dhe promovimin e praktikave më të mira.
3.4 Vëzhgon orë mësimore te mësuesit dhe ofron rekomandime për përmirësimin e cilësisë së tyre.			
Pak vëzhgime të kryera; reagimet janë minimale ose të padobishme.	Kryen vëzhgime dhe ofron rekomandime bazë.	Vëzhgime të rregullta me reagime konstruktive dhe të detajuara.	Vëzhgime të shpeshta dhe të thella; ofron reagime të detajuara dhe vepruese; ndjek për të siguruar zbatimin e rekomandimeve.
3.5 Mbështet zbatimin e risive kurrikulare në shkollë dhe propozon me shkrim përmirësime të kurrikulës dhe të teksteve shkollore, të cilat i dorëzon në përfundim të vitit shkollor në drejtorinë e shkollës.			
Mbështetje minimale për inovacione; rrallë propozon përmirësime.	Mbështetje bazë për inovacionet e kurrikulës; sugjerime të herëpashershme për përmirësime.	Mbështet në mënyrë aktive zbatimin e inovacioneve të kurrikulës; propozon rregullisht përmirësime të mirëmenduara.	Mbështet në mënyrë inovatore risitë kurrikulare; propozon vazhdimisht përmirësime inovative të bazuara në kërkime; vlerëson dhe raporton në mënyrë sistematike mbi efektivitetin e zbatimit të kurrikulës.

3.6 Koordinon punën për planifikimin dhe zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle në përputhje me nevojat dhe interesat e nxënësve, si dhe bazuar në kontekstin e shkollës.

Përfshirje minimale në zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle.	Koordinim bazë i planifikimit ekzistues të kurrikulës në bazë shkolle.	Koordinon në mënyrë aktive zhvillimin gjithëpërfshirës të kurrikulës në bazë shkolle, duke marrë parasysh nevojat e nxënësve dhe kontekstin e shkollës.	Udhëheq një qasje inovative dhe bashkëpunuese për zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle; siguron që kurrikula të jetë shumë e përgjegjshme ndaj nevojave, interesave dhe kontekstit shkollor të nxënësve duke përdorur module të reja; vlerëson vazhdimisht procesin.
---	--	---	---

3.7 Propozon ide inovatore në organizimin e aktiviteteve shkollore, me synimin për t'iu përgjigjur nevojave të nxënësve dhe pritshmërive të prindërve dhe të komunitetit.

Rrallë propozon ide të reja; sugjerimet nuk janë inovative ose nuk u përgjigjen nevojave të palëve të interesuara.	Herë pas here propozon ide, kryesisht me natyrë tradicionale.	Propozon rregullisht ide novatore që marrin parasysh nevojat e nxënësve dhe pritshmëritë e komunitetit.	Gjeneron dhe zbaton vazhdimisht ide shumë inovative dhe me ndikim; kërkon në mënyrë proaktive të dhëna nga nxënësit, prindërit dhe komuniteti; krijon një kulturë për nxitjen e inovacionit në aktivitetet e shkollës.
--	---	---	--

13.10 Shtojca 10: Databaza e të dhënave për çdo mësues për identifikimin e nevojave për ZHVP-së

DRAP: _____ ZVAP: _____

Emri i shkollës: _____

Nr.	Emër dhe mbiemër i mësuesit	Lënda	Cikli	Vjetërsia në punë	Kategoria e kualifikimit	Numri i krediteve të fituara për vit shkollor	Aktivitete të akredituara						Aktivitete të njohura me kredite	Vlerësimi i performancës në fund të vitit shkollor
							Tema Trajnime	Tema Mikrokredenciale	Tema Konferenca	Tema Seminare	Tema Ëorkshope	Konkurse, olimpiada, kampionat e në nivel kombëtar		
1														
2														
3														
4														
5														
6														
7														
8														
9														
10														
11														
12														
13														

Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë: _____

Firma: _____